



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31 regjistër (JR)  
Datë 13.06.2019

Nr. 14 i vendimit  
Datë 15.06.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 15.06.2021, ora 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 31 (JR), datë 13.06.2019, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, me detyrë prokurore/drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 109, datë 19.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e saj të paraqitura në ankim dhe në seancë gjyqësore, e cila kërkoi

përfundimisht të vlerësohet se kalon testin e besueshmërisë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj Irma Balli, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurores dhe njëkohësisht drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe, për rrjedhojë, ajo gëzonte statusin e magjistrates<sup>1</sup>. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, znj Irma Balli iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) brenda afatit ligjor<sup>2</sup>, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë<sup>3</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
  - (ii) *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Ka kryer deklaram të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Grupi i Punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 109, datë 19.02.2019.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 109, datë 19.02.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, me detyrë prokurore/drejtuese e Prokurorisë së Apelit Korçë [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

**6.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë,** në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklarin e burimeve

---

<sup>1</sup> Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe prokurori, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

<sup>2</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>3</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

financiare, deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse, balancë negative për vitet 2003, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, si dhe dyshime të arsyeshme për ndërhyrje të pajustificuar në dokumentacionin tekniko-ligjor, të depozituar në ZVRPP-në Korçë për regjistrimin e pasurisë, duke bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 109, datë 19.02.2019, me pretendimin se ky është një vendim i njëanshëm, i pabazuar në ligj, si dhe i marrë në cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi i Komisionit është rezultat i zbatimit në mënyrë të gabuar prej këtij të fundit, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sikundër dhe rezultat i një procesi të paragjykuar, në mungesë të analizës së provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit pranë Komisionit, si dhe në shkelje të parimit të kontradiktoritetit.
8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, pretendoi gjithashtu se Komisioni, gjatë shqyrtimit të çështjes së saj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi nuk ka vlerësuar në tërësi pasurinë e saj në përputhje me qëllimin e ligjit, por përkundrazi, sipas saj, Komisioni ka bërë sforcime logjike në interpretim, me qëllim gjetjen e justifikimeve për arritjen e një përfundimi të paracaktuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, pjesë e këtij qëndrimi është edhe fakti që procesi i rivlerësimit të saj në Komision ka zgjatur mbi 12 muaj dhe kjo zgjatje nuk është kushtëzuar nga ndonjë nevojë e veçantë. Gjithashtu, subjekti pretendoi se, në kundërshtim me parashikimet e nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, vendimi i shkarkimit nga detyra i është njoftuar 90 ditë pas marrjes së tij, duke i privuar për një kohë të gjatë të drejtën kushtetuese dhe ligjore që lidhet me ushtrimin e ankimit ndaj këtij vendimi.
9. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ankimin e saj e shoqëroi me disa akte shkresore, të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provave të reja, në përputhje me nenet 45, pikat 1 dhe 2, 49 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 63, pika 1, 65 e 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a” “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
  - *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 109 vendimi, datë 19.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Irma Balli.*
  - *Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit, që lidhen me figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Irma Balli.*
  - *Ndryshimin e vendimit nr. 109, datë 19.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Irma Balli, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Apelit Korçë.*
10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

i. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “pikë karburanti + ndërtesë”, me adresë: Bulevardi “{\*\*\*}”, Korçë, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me ¼ pjesë të pasurisë

**10.1.** *Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e problematikave të dokumentacionit tekniko-ligjor mbi ndërtimin dhe regjistrimin e objektit “pikë karburanti + ndërtesë”, është i gabuar, i pabazuar në ligj dhe paragjykues.*

**10.2.** *Konkluzioni i Komisionit për mospërputhje në deklaratimet e ndryshme të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e investimit fillestar të kësaj pasurie të paluajtshme, si dhe për pasaktësi në deklaratim në lidhje me sipërfaqen reale të objektit dhe vlerës totale të investuar për ndërtimin e tij, është konkluzion i pabazuar në fakte dhe rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të dy koncepteve të ndryshme, si ato lidhur me vlerën e investimit dhe vlerën e pasurisë.*

**10.3.** *Subjekti pretendoi se pasaktësia e ekspertit në aktvlerësimin e pasurisë, duke mos pasur në vëmendje në përllogaritjet e tij vetëm 12,4 m<sup>2</sup>, nuk mund të vlerësohet nga Komisioni si tendencë apo mjet për të fshehur vlerën e saktë të pasurisë, për sa kohë sipas parashtrimeve në ankim, vlera e deklaruar e pasurisë, është në fakt një vlerë më e madhe nga ajo që është realisht.*

**10.4.** *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon investimin e kryer në këtë pasuri të paluajtshme, si pasojë e mosjustifikimit me dokumentacion ligjor të burimit të të ardhurave të krijuara nga emigracioni i bashkëshortit, është i gabuar, pasi të ardhurat nga emigracioni nuk kanë qenë burimi i vetëm i deklaruar për krijimin e kësaj pasurie dhe se të ardhurat nga burimet e tjera të deklaruara kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie.*

**10.5.** *Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke trajtuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në lidhje me investimin e kryer për ndërtimin e objektit “pikë karburanti + ndërtesë”, babanë, motrën dhe vëllanë e saj, ndërkohë që ata janë persona të tjerë të lidhur, sipas kësaj dispozite, vetëm në lidhje me dhurimin prej tyre të ¼ pjesë të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 170 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është kryer investimi në fjalë. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të gabuar dhe të pabazuar në fakte, ka arritur në konkluzionin që tre bashkëpronarët e tjerë nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pjesën e tyre të pasurisë në bashkëpronësi.*

**10.6.** *Konkluzioni i Komisionit se sipërfaqja prej 12,4 m<sup>2</sup>, në papafingon e objektit, është e pambuluar me dokumentacion ligjor, është i gabuar dhe i pambështetur në fakte, pasi nëse ky konkluzion do të përbënte një fakt të vërtetë, atëherë kjo sipërfaqe do t'i ishte nënshtruar procesit të legalizimit në vitin 2014-2015. Konkluzioni në vijim i Komisionit për deklaratim të pamjaftueshëm të kësaj pasurie është i pabazuar në ligj, pasi subjekti nuk ndodhet në situatën e mosjustifikimit me burime të ligjshme të kësaj pasurie, apo të ketë tentuar ta fshehtë apo të ketë bërë deklaratim të rremë të saj.*

**10.7.** *Komisioni ka gabuar në arritjen e konkluzionit se subjekti ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm, si pasojë e mosdeklarimit të sipërfaqes së legalizuar, prej 12,5 m<sup>2</sup>, në vitin e ndërtimit, si dhe mosdeklarimit të sipërfaqes reale të papafingos në deklaratën e pasurisë vetting.*

ii. Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë “pikë karburanti”, me adresë në Bulevardin “{\*\*\*}”, Korçë

**10.8.** *Komisioni ka gabuar në vlerësimin si të paligjshme të një pjese të të ardhurave të krijuara nga qiradhënia e pikës së karburantit në periudhën 2011-2014, me arsyetimin se për disa prej*

*pagesave të qirasë nuk u provua që për këto vlera të jetë përmbushur detyrimi i pagimit të tatimit në burim, pasi në rastin kur qiramarrësi është subjekt tregtar, ligji ngarkon atë me mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja dhe derdhjen e tyre në buxhetin e organit tatimor përkatës në cilësinë e agjentit tatimbledhës.*

iii. Lidhur me analizën financiare për vitet 2003 dhe 2011-2014

**10.9.** *Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka kryer analizë financiare për periudhën e viteve 1994-2002 dhe, për pasojë, rezultati i analizës financiare të vitit 2003 nuk ka marrë në konsideratë kursimet e realizuara në vlerën prej 1.000.000 lekësh deri në fund të vitit 2002.*

**10.10.** *Tabelat financiare të cilat paraqesin analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitet 2011-2014, janë të pasakta dhe të plotësuara me të dhëna të manipuluar.*

iv. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “njësi”, të regjistruar si të tillë në ZVRPP-në Korçë, por të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si “garazh”

**10.11.** *Konkluzioni i Komisionit se lidhur me këtë pasuri të paluajtshme ka mospërputhje mes të dhënave të regjistrimit të pasurisë dhe deklarimeve të subjektit sa i takon llojit të saj, me impakt në trajtimin e ndryshëm financiar të kësaj pasurie në sistemin tatimor, është konkluzion i gabuar dhe rrjedhojë e mungesës së arsyesimit dhe mosnjohjes së legjislacionit në fushën e tatimeve, konkretisht ligjit lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe atij për taksat vendore.*

**10.12.** *Komisioni, në mënyrë të gabuar, ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e garazhit në vitin 2011, si pasojë e mosvlerësimit të drejtë të përdorimit të likuiditeteve gjendje cash.*

v. Lidhur me transaksionin e konvertimit në 26.000 euro në vitin 2009, të likuiditeteve gjendje në lekë

**10.13.** *Komisioni ka gabuar në trajtimin e transaksionit të konvertimit si mosdeklarim në DIPPV-në e vitit 2009, duke qenë se në formularin e deklarimit të vitit 2009 kërkohet deklarimi i likuiditeteve, pa u shprehur kërkesa për paraqitjen e tyre të detajuar sipas çdo monedhe të mundshme të poseduar nga subjekti deklarues.*

vi. Lidhur me të ardhurat nga biznesi “{\*\*\*}” ShPK

**10.14.** *Konkluzioni i Komisionit për mospërputhje midis të ardhurave në deklaratimet periodike të pasurisë për periudhën 2003-2010 dhe deklaratën e pasurisë vetting është i gabuar, duke qenë se në deklaratat periodike janë deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke filluar nga viti i parë i deklarimit 2003, ndërkohë që në deklaratën e pasurisë janë deklaruar të ardhurat e krijuara nga gjithë aktiviteti i shoqërisë në fjalë, e cila daton që në vitin 2001. Edhe metodologjia e përdorur nga Komisioni për përcaktimin e fitimit nga aktiviteti tregtar i Shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas metodës së mesatares së ponderuar, është i gabuar.*

**10.15.** *Komisioni ka gabuar në konkluzionin e arritur mbi pasaktësitë në gjendjen e kursimeve cash të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, si dhe ka cenuar të drejtën e kësaj të fundit për proces të rregullt ligjor, duke qenë se nuk e ka njohur atë me gjetjet lidhur me ndryshimin e tabelave financiare që lidhen me likuiditetet.*

11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*11.1. Komisioni ka cenuar standardin kushtetues për dhënien e masës së shkarkimit si pasojë e vetëm një kriteri të rivlerësimit, atij të pasurisë, të përcaktuar nga neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61 i ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti shkarkohet nëse pasuria e tij është sa dyfishi i të ardhurave të ligjshme.*

*11.2. Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke cenuar qëllimin e ligjit dhe të Kushtetutës, duke qenë se pamjaftueshmërinë në deklaram lidhur me kriterin e pasurisë dhe atë të figurës i ka vlerësuar si kritere alternative, ndërkohë që vetë dispozita ligjore, në kuadër të vlerësimit për dhënien e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, i parashikon ato si kritere kumulative. Gjithashtu, subjekti pretendoi zbatim të gabuar të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, edhe në drejtim të kuptimit të konceptit të “deklarimit të pamjaftueshëm” lidhur me pasurinë.*

*11.3. Komisioni ka cenuar parimin e barazisë, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit me standarde të dyfishta, ku për çështje të njëjta ka mbajtur qëndrime të ndryshme në raste të mëparshme të rivlerësimit kalimtar.*

*11.4. Procesi i rivlerësimit në Komision ka qenë i paragjykuar dhe vendimmarrja e tij e paravendosur, duke qenë se, përveç kohës së gjatë prej një viti të hetimit administrativ, pa pasur një nevojë të veçantë, hetimet përfunduan vetëm për kriterin e pasurisë dhe rezultatet e hetimit mbi kriterin e aftësive profesionale dhe kriterin e kontrollit të figurës nuk u përfshinë në procesin e rivlerësimit. Mbi të gjitha, afati i caktuar prej vetëm 8 ditësh për të dhënë shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe për të përmbushur barrën e provës lidhur me to, ishte tejet i shkurtër.*

*11.5. Seanca dëgjimore ka qenë thjesht një formalitet dhe nuk është përmbushur qëllimi i mbajtjes së saj, për sqarimin e rrethanave të çështjes dhe analizimin e provave të paraqitura, si dhe është cenuar parimi i kontradiktoritetit, pasi një sërë gjetjesh të Komisionit lidhur me pasurinë e subjektit janë evidentuar për herë të parë në vendimin e tij dhe nuk janë bërë objekt diskutimi në seancën dëgjimore, duke sjellë si pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor.*

*11.6. Vendimit të Komisionit objekt ankimi i mungon arsyetimi ligjor lidhur me përmbushjen e kriterit kushtetues në të cilin referon neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra. Komisioni është mjaftuar vetëm në kritere subjektive, siç është bindja e brendshme e trupit gjykues për të konstatuar se ka deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur

për rivlerësimin e subjektit, znj. Irma Balli, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>4</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 109, datë 19.02.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi. Gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi, u konstatua se shkak i ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të së drejtës së saj për t'u njohur, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur lidhur me të gjitha gjetjet e Komisionit nga hetimi administrativ, ishte i pamundur të shqyrtohej mbi bazë dokumentacioni, pasi akti procedural lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, në të cilin evidentohen gjetjet e Komisionit dhe për të cilat subjektit i kalon barra e provës për të provuar të kundërtën e tyre, nuk ishte pjesë e fashikullit të çështjes së përcjellë nga ana e Komisionit në Kolegj. Për pasojë, trupi gjykues vendosi t'i kërkojë Komisionit përcjelljen pranë Kolegjit të dokumentit lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioni nuk përcolli në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit aktin procedural "Rezultatet paraprake të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë" në formën e një akti zyrtar. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, për t'i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e saj para trupit gjykues të Kolegjit. Në këtë mënyrë, trupi gjykues zgjidhi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljet nga ana e Komisionit të parimeve të përgjithshme në kuadër të procesit të rregullt ligjor dhe aspekteve të tjera me natyrë procedurale.

---

<sup>4</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 109, datë 19.02.2019, për rivlerësimin e subjektit Irma Balli, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën {\*\*\*} prot., datë 17.05.2019. Edhe pse në fashikull nuk ka dokumentacion provues lidhur me mënyrën e komunikimit me subjektin e rivlerësimit në kuadër të njoftimit të vendimit, ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 31.05.2019, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2019, që rezulton të jetë dita e 14-të nga data e shkresës së Komisionit për njoftimin e vendimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, e ka dorëzuar ankimin e saj në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

15. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “pikë karburanti + ndërtesë” në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me z. N. R.<sup>5</sup>, P. R. dhe M. K. S. me adresë: Bulevardi “{\*\*\*}”, Korçë, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i arritur nga Komisioni është i gabuar dhe paragjykes, trupi gjykues, konstatoi si vijon.*

*i) Lidhur me origjinën e pasurisë*

16. *Komisioni, pas kontrollit dhe vlerësimit të kësaj pasurie të paluajtshme në kuadër të procesit të rivlerësimit, sa i takon origjinës së saj ka arsyetuar në vendim: [...] Nga verifikimi i praktikës së lejes së ndërtimit të dërguar në Komision nga Drejtoria Rajonale e Arkivave Shtetërore Elbasan (në vijim referuar “DRASh Elbasan”) dhe ZVRPP-ja Korçë, nuk rezulton që praktika e lejes së ndërtimit për pasurinë “Karburant dhe ndërtesë 3 kate + papafingo” të jetë dërguar me shkresë përcjellëse nga zyra e urbanistikës së Këshillit të Rrethit Korçë. Gjithashtu, në dosje nuk rezulton ndonjë kërkesë nga personi i interesuar, z. N. R., për dërgimin nga zyra e urbanistikës të praktikës së lejes së ndërtimit për regjistrim pranë ZVRPP-së Korçë. Kjo do të thotë që praktika e lejes së ndërtimit, ku përfshihen edhe planimetritë e katit I, II dhe III, është dorëzuar nga vetë aplikuesi, në rastin konkret subjekti i rivlerësimit, si dokumentacion që shoqëron aplikimin në ZVRPP për regjistrim fillestar të pasurisë (aplikimi nr. {\*\*\*}, datë 7.07.2000) duke u paguar edhe tarifa përkatëse financiare sepse në të kundërt ZVRPP-ja nuk do të ishte vënë në lëvizje për regjistrimin e kësaj pasurie. Në kuadër të arsyetimit të mësipërm, Komisioni është shprehur në vendim se ka arritur në konkluzionin<sup>6</sup>: Për sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje të dokumentacionit tekniko-ligjor të praktikës së lejes së ndërtimit të pasurisë “Karburant dhe ndërtesë 3 kate + papafingo”, në emër të shtetasit N. R., të ndodhur në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore Elbasan, me dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ZVRPP-në Korçë, nëpërmjet aplikimit për regjistrimin fillestar nr. {\*\*\*}, datë 17.07.2000, për regjistrimin e kësaj pasurie, ndërkohë që ai duhet të ishte i njëjtë.*
17. *Në konkluzionin përfundimtar lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioni është shprehur në vendim se subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse, balancë financiare negative për vitet 2003, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, si dhe dyshime të arsyeshme për ndërhyrje të pajustificuar në dokumentacionin tekniko-ligjor të depozituar në ZVRPP-në Korçë për regjistrimin e pasurisë, duke bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.*
18. *Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të gabuar dhe paragjykes vendimin e Komisionit në drejtim të vlerësimit të problematikave lidhur me dokumentacionin tekniko-ligjor të ndërtimit të objektit “pikë karburanti + ndërtesë”, ndërtuar në tokën në bashkëpronësi me familjarët e saj. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se asnjë prej rrethanave që*

<sup>5</sup> Aktualisht, referuar të dhënave të kartelës së pasurisë të lëshuar nga ZVRPP Korçë, kjo pasuri ndodhet në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me z. P. R. (vëllai i subjektit), znj. M. K. (motra e subjektit) dhe A. R. dhe Dh. R. (dy fëmijët e vëllait të subjektit), të cilët e kanë fituar statusin e bashkëpronarit si pasojë e trashëgimisë testamentare nga trashëgimlënësi N. R..

<sup>6</sup> Shih paragrafin e dytë në faqen 12 të vendimit të Komisionit.



përmend Komisioni për formimin e dyshimit të arsyeshëm për ndërhyrje të pajustificuar në dokumentacionin tekniko-ligjor të depozituar në ZVRPP Korçë, nuk rezulton të jetë objekt i ndonjë analize shkencore, për të krijuar bindjen e mësipërme.

19. Ndërkohë që, sa i takon konkluzionit për deklaram të pamjaftueshëm të kësaj pasurie në drejtim të problematikave të dokumentit tekniko-ligjor, subjekti pretendoi se arsyetimi i Komisionit nuk lidhet me elementet që kërkon ligji, lidhur me pamjaftueshmërinë e deklaramit, por lidhet vetëm me çështje teknike dhe pasaktësi dokumentacioni, skicash e planimetrish, të cilat nuk janë objekt i këtij vlerësimi. Në kuadër të sqarimeve në lidhje me këtë shkak të ankimit, subjekti pretendoi se lidhur me pasurinë në fjalë, ata (bashkëpronarët) janë ndeshur me problematika në drejtim të saktësisë së dokumentacionit të regjistrimit pranë ZVRPP Korçë, për të cilat kanë aplikuar për korrigjimin e tyre. Gjithashtu, sipas subjektit, bashkëpronarët e pasurisë në fjalë kanë evidentuar problematika në drejtim të sa më sipër edhe në DRASh-në Elbasan, fakt të cilin subjekti shprehet se Komisioni nuk e bën prezent. Subjekti pretendoi se mungesa e një procesverballi të dorëzimit nga ana e pronarëve të dokumenteve lidhur me këtë pasuri, e shkarkon atë moralisht dhe ligjërisht nga përgjegjësia mbi gjendjen e sotme të dokumentacionit në arkivat shtetërore. Inventari i dokumentacionit mbi pronën e subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, dhe të familjarëve të saj, lidhur me regjistrimin e vitit 2000, është hartuar në vitin 2008 dhe rezulton të jetë një procedurë e njëanshme, pa prezencën e tyre. Sikundër dhe kërkesa për leje ndërtimi nga babai i saj në vitin 1997 nuk rezulton, sipas subjektit të rivlerësimit, që të jetë e nënshkruar prej tij. Subjekti ngre pretendimin se regjistrimi i kësaj pasurie është kryer nga zyra përgjegjëse e ZVRPP-së Korçë, e cila mban dhe përgjegjësinë e verifikimit dhe kontrollit të dokumenteve dhe gjendjen në fakt të objektit. Për më tepër, sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pasuri ka qenë objekt i projektit pilot të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Korçë dhe në asnjë rast nga kontrolli nuk është gjetur ndonjë problematikë.
20. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi se dokumentacioni i administruar nga ZVRPP Korçë<sup>7</sup> lidhur me *referencën* {\*\*\*}, që i korrespondon regjistrimit fillestar të kësaj pasurie, nuk përputhet plotësisht me dokumentacionin e administruar nga DRASh Elbasan<sup>8</sup>, sa i takon dokumentacionit teknik (planimetrive lidhur me objektin e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 10.11.1997). Në materialin e përcjellë nga institucioni arkivor, përveç studimit urbanistik, planimetrive të katit përdhe dhe katit “tip”, ka dhe një sërë dokumentesh të tjera të cilat duket të jenë, një pjesë prej tyre dokumente paraprake të cilat nuk kanë shenjë miratimi nga organi kompetent, një pjesë tjetër akte teknike, si projekte instalimesh teknike, certifikime të punimeve në faza të ndryshme të zbatimit të projektit etj.
21. Nga verifikimi i praktikës së përcjellë nga DRASh Elbasan, trupi gjykues konstatoi se institucioni arkivor informonte Komisionin për kërkimet e kryera në dokumentet arkivore që dispononin dhe dërgimin e një materiali prej dyzet fletësh fotokopje, ndërkohë që vuri re se numri i fletëve të përcjella nuk përputhej me numërtimin fillestar të tyre. U konstatua që numërtimi i këtij dokumentacioni ishte i çrregullt, më konkretisht u vunë re shkoputje në numërtim të dokumenteve të përcjella dhe se numri më i madh i përdorur për numërtimin e dokumenteve, pjesë e dosjes së vendimeve të KRrT Korçë, {\*\*\*}, të AShV Korçë, F. KRrT Korçë, V. 1997, ishte numri 72 dhe

<sup>7</sup> Sipas shkresës së ZVRPP-së Korçë nr. {\*\*\*} prot., datë 14.012.2018.

<sup>8</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 27.12.2018.

jo 40, sa numri i fletëve të përcjella, çka krijoi bindjen e trupit gjykues që dokumentacioni i kësaj dosjeje nuk ishte i plotë, referuar dokumentacionit të administruar si pjesë e saj në vitin e krijimit.

22. Në kuadër të sa më sipër konstatuar, fillimisht trupi gjykues gjen me vend të evidentojë se është e pamundur të arrihet në një përfundim të drejtë dhe objektiv për mospërputhje dokumentacioni mes dokumentacionit të arkivuar në ZVRPP Korçë dhe DRASH Elbasan, nëse dosja pranë DRASH Elbasan nuk paraqet situatën reale të dokumentacionit që ka qenë gjendje në Këshillin e Rrethit Korçë lidhur me lejen e ndërtimit objekt kontrolli nga Komisioni.
23. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë nga DRASH Elbasan, u konstatua gjithashtu se ka akte të cilat krijojnë mospërputhje mes tyre, duke krijuar paqartësi rreth dokumentacionit teknik përfundimtar. Më konkretisht, në arkivin e këtij institucioni ndodhet një kërkesë për shesh ndërtimi, sipas formularit 1, me datë 10.06.1997, e kërkuarit A. R., sipas së cilës ai kërkon leje për shesh ndërtimi për objektin pikë karburanti, me sipërfaqe ndërtimi rreth  $100 m^2$ , me nr. *katesh 1 dhe 2*. Ndërkohë, në të njëjtën dosje, ndodhet një kërkesë për leje ndërtimi, sipas formularit 3, me datë 10.06.1997, me të njëjtën datë si e kërkesës për shesh ndërtimi. Kjo kërkesë për leje ndërtimi nuk është e nënshkruar nga kërkuari i saj, por vihet re që ka marrë të gjitha miratimet e nevojshme. Një fakt tjetër që bie në sy në këtë dokument, është edhe përshkrimi në rubrikën 5 të tij, e cila referon në një vendim për dhënie sheshi ndërtimi të dt. 25.04.1995, me projekt të hartuar nga z. M. B. dhe jo nga z. A. P., i cili është dhe projektuesi i përmendur në aktin e kolaudimit të objektit. Gjithashtu, në morinë e akteve të përcjella nga DRASH Elbasan, trupi gjykues konstatoi ekzistencën e disa projekteve (planimetri-planvendosje) të nënshkruara edhe nga ing. M. B., përveç atyre të nënshkruara nga z. A. P., i cili është projektuesi i objektit të ndërtuar. Referuar kësaj situate kaotike dokumentare, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni nuk ka pasur qartësi dokumentare se cili ka qenë projekti përfundimtar, ai i cili është zbatuar në rastin konkret, sikundër dhe cilat kanë qenë kondicionet urbanistike për të cilat është dhënë leja për shesh ndërtimi, për sa kohë formulari nr. 2, që duhet të shoqëronte lejen për shesh ndërtimi dhe në të cilën përcaktohen të gjitha kondicionet urbanistike mbi bazën e të cilave projektohet objekti që do të ndërtohet<sup>9</sup>, nuk është pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga DRASH Elbasan<sup>10</sup>. Për rrjedhojë, Komisioni nuk ka pasur mundësi objektive për të vlerësuar nëse dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Korçë (planimetritë e objektit) përputhet me dokumentacionin që ndodhet në DRASH Elbasan, sa i takon numrit të akteve të objektit të ndërtuar.
24. Sa i takon çështjes së regjistrimit të objektit të ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, trupi gjykues konstaton se legjislativi i posaçëm në fuqi në kohën e përfundimit të ndërtimit parashikonte në nenin 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar:  
*Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni ose zyra e urbanistikës, pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit.*  
*Me kërkesën e zotëruesit të sheshit të ndërtimit, seksioni a zyra përkatëse urbanistike i dërgon zyrtarisht zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti, konfirmimin zyrtar të përfundimit të punimeve të ndërtimit të objektit në përputhje me ligjin, projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit. Këtij dokumenti i bashkëngjiten kopjet e akteve vijuese:*

<sup>9</sup> Referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

<sup>10</sup> Në fashikull ndodhet vetëm vendimi nr. {\*\*\*}, datë 20.06.1997, i Këshillit të Rregullimit të Territorit Korçë, për miratimin e disa shesheve ndërtimi për objekte definitive, ndër to edhe për pikën e karburantit në shëtitoren “{\*\*\*}” me investitor z. A. R., por jo formularët nr. 2, në të cilët janë miratuar kondicionet urbanistiko-arkitektonike përkatëse.

- leja për sheshin e ndërtimit;
- leja e ndërtimit;
- procesverbali i kolaudimit të objektit;
- leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit;
- plani i vendosjes së objektit;
- dokumente të tjera që përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar.

*Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë të të interesuarit.*

25. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se dërgimi i dokumentacionit të përcaktuar në nenin 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” nga seksioni i urbanistikës në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme përbën një parakusht të detyrueshëm për efekt të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme. Në këto kushte edhe në eventualitetin që subjekti i rivlerësimit (apo secili prej bashkëpronarëve) së bashku me aplikimin për regjistrim fillestar të pasurisë të ketë paraqitur kopje të tij të dokumentacioni, ky dokumentacion i nënshtrohet verifikimit nga ana e zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në drejtim të përputhshmërisë së tij me aktet e përcjella zyrtarisht nga seksioni i urbanistikës, i cili konfirmon ekzistencën e një ndërtimi të ligjshëm, sipas kushteve urbanistike të miratuara nga organi kompetent. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se regjistrimi është kryer sipas akteve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat sipas Komisionit nuk janë të njëjta me ato të ndodhura në Arkivin Shtetëror Vendor nuk është konkluzion i bazuar në faktet e provuara gjatë hetimit administrativ dhe në ligj.
26. Për më tepër, edhe konkluzioni tjetër i Komisionit, sipas të cilit *nuk rezulton që praktika e lejes së ndërtimit për pasurinë "Karburant dhe ndërtesë 3 kate + papafingo" të jetë dërguar me shkresë përcjellëse nga zyra e urbanistikës së Këshillit të Rrethit*, është i pabazuar në fakte dhe në ligj, për sa kohë në ZVRPP nuk dërgohet e gjithë praktika e një leje ndërtimi, por vetëm aktet e përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenin 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, të cilat shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, të krijuar sipas një akti administrativ që është leja e ndërtimit<sup>11</sup>. Gjithashtu, fakti që shkresa përcjellëse e seksionit të urbanistikës nuk gjendet në dokumentacionin e arkivuar në DRASH Elbasan (siç referon Komisioni në vendim), nuk duhet ta kishte çuar Komisionin në konkluzionin që kjo shkresë nuk ka ekzistuar 22 vite më parë, pasi referuar Listës Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit, në pjesën “V. 6. Ndërtimi”, sa u takon dokumenteve mbi projektimin dhe ndërtimin e objekteve të banimit, rezulton se vetëm *studimet, raportet, vendimet, udhëzimet, relacionet e evidencat përmbledhëse, dokumentacioni teknik tërësor dhe dokumente të tjera të këtij lloji* janë përcaktuar me afat ruajtje të përhershme si dokumentacion i cili përbën pasuri arkivore me rëndësi historike kombëtare, ndërkohë që korrespondenca e thjeshtë lidhur me këto çështje, siç është edhe kërkesa e investitorit drejtuar zyrës së urbanistikës, si dhe shkresa përcjellëse e kësaj të fundit drejtuar ZVRPP-së, në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, ka afat maksimal ruajtjeje 10 vjet.

<sup>11</sup> Shih dhe parashikimet e rregullores “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të miratuar nga kryeregjistruesi me nr. 184 prot., datë 08.04.1999.

27. Në përfundim, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit për mospërputhje të dokumentacionit të administruar nga dy burime të ndryshme arkivore nuk mund të konfirmohet si konkluzion i drejtë dhe i bazuar, për sa kohë, referuar analizës së mësipërme, rezultoi se dokumentacioni i administruar nga DRASh-ja e Elbasanit, mbi bazën e të cilit Komisioni ka vlerësuar saktësinë dhe përputhshmërinë e dokumenteve të cilat kanë shërbyer për regjistrimin e pasurisë objekt kontrolli në ZVRPP Korçë, rezultoi të jetë i paplotë. Për rrjedhojë, edhe arsytimi i Komisionit se si pasojë e sa më sipër ngrihen dyshime për ndërhyrje nga ana e subjektit të rivlerësimit në dokumentacionin e dorëzuar pranë ZVRPP-së, përveçse nuk ka asnjë provë apo qoftë dhe indicie në drejtim të sa më sipër, rezultoi të jetë edhe i pambështetur në parashikimet ligjore të kohës në të cilën kanë ndodhur faktet e sipërcituara. Trupi gjykues vlerësoi që në kuadër të parimit të objektivitetit në gjykim, problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit për sa kohë nga procesi i rivlerësimit nuk u evidentuan gjetje në drejtim të veprimeve të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër.

*ii) Lidhur me vlerën dhe sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme “pikë karburanti + ndërtesë”*

28. Lidhur me vlerën e investimit fillestar për krijimin e pasurisë së paluajtshme objekt shqyrtimi, si dhe në lidhje me vlerën e pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij: *Rezulton se ka mospërputhje në lidhje me vlerën e investimit fillestar në objektin e llojit "Karburant dhe godinë 3 kate + papafingo" midis: deklaratimit periodik vjetor të vitit 2003 (ku është deklaruar se shuma e investuar prek 10 milionë lekë), si dhe deklaratimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2 (ku shuma e investuar është deklaruar 9 milionë lekë). Të dyja këto deklarime bien në kundërshtim me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2000, sipas së cilës të katër bashkëpronarët kanë investuar në mënyrë të barabartë, ashtu siç janë të katërt bashkëpronarë të truallit, në pjesë të barabarta, pavarësisht se si investitor del vetëm emri i babait të subjektit, z. N. R.. [...] Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se, sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2015, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 132,4 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e shtesës së legalizuar është 12,5 m<sup>2</sup>, shpjegimet e dhëna nga subjekti se sipërfaqja e papafingos, sipas udhëzimeve përkatëse, është marrë sa gjysma e sipërfaqes së katit, duke ruajtur të pandryshuar çmimin lekë/m<sup>2</sup>, sipërfaqja ndërtimore sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2011, është 120 m<sup>2</sup>, çmon se në përcaktimin e vlerës totale të investimit nuk është llogaritur vlera për sipërfaqen e legalizuar prej 12,5 m<sup>2</sup>, si dhe rezultoi një sipërfaqe prej 12,4 m<sup>2</sup> (144,9 m<sup>2</sup> - (120 + 12,5) = 12,4 m<sup>2</sup>, e pambuluar me dokumentacion justifikues ligjor dhe e pallogaritur në vlerën totale të investimit. Pra, kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaratim në lidhje me sipërfaqen reale dhe me vlerën totale të investuar për ndërtimin e objektit në fjalë.*

29. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mospërputhje në deklaratimet e saj lidhur me vlerën e investimit fillestar, pasi sipas subjektit në këto deklarime është dhënë vlera e pasurisë në kohë dhe jo vlera e investimit fillestar. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka gabuar edhe në vlerësimin që i ka bërë një deklaratë noteriale të vitit 2000. Subjekti pretendoi se kjo deklaratë e dhënë në kushtet e një marrëdhënieje të posaçme familjare që lidh personat e përfshirë në cilësinë e bashkëpronarëve, nuk ka pasur për synim të përcaktojë vlerën e investimit fillestar, por të përcaktojë pjesët e secilit në këtë pasuri të paluajtshme që po krijohej në tokën në bashkëpronësi, në kuadër të lejes së ndërtimit të nxjerrë nga babai i subjektit të rivlerësimit, kohë më parë se subjekti të fitonte pronësinë në ¼ pjesë të pasurisë tokë truall me sipërfaqe 170 m<sup>2</sup>. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, pretendoi gjithashtu se, sa i takon mungesës së dokumentacionit justifikues mbi vlerën e investimit sipas

lejes së ndërtimit, kjo nuk është përgjegjësi e saj. Për shkak edhe të kohës së gjatë që ka kaluar dhe përpjekjeve pa sukses të kryera për marrjen e këtij dokumenti nga kompania ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, subjekti kërkoi nga trupi gjykues që mosdorëzimi i dokumentacionit justifikues lidhur me sa më sipër, të vlerësohet në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si pamundësi objektive. Për më tepër që, sipas subjektit të rivlerësimit, marrëdhënia kontraktuale mes babait të saj dhe kompanisë sipërmarrëse për ndërtimin e pikës së karburantit është lidhur përpara se subjekti, nëpërmjet kontratës së dhurimit të datës 05.06.1998, të bëhej bashkëpronare me ¼ pjesë të truallit mbi të cilin është ngritur ndërtimi.

30. Ndërkohë, sa i takon konkluzionit të Komisionit për pasaktësi në deklaram në lidhje me sipërfaqen reale të objektit dhe vlerën totale të investuar për ndërtimin e objektit në fjalë, subjekti pretendoi se Komisioni ka arritur në këtë konkluzion të gabuar si pasojë e konfondimit të dy koncepteve të ndryshme, siç janë vlera totale e objektit “me kosto ndërtimi” dhe vlera “totale e investimit”. Në mbështetje të këtij shkak të ankimit, subjekti pretendoi se vlera e objektit, e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, është sipas një aktvlerësimi të kryer më datë 21.06.2016, nga një ekspert i vlerësimit të pasurive të paluajtshme, z. J. S.. Ky aktvlerësim, sipas subjektit, është kryer duke iu referuar koston së objektit, sipas çmimit për sipërfaqe shfrytëzimi të vitit 2016, e cila është 38.000 lekë/m<sup>2</sup> sipas EKB-së, ndërkohë që duhej të ishte vlerësuar sipas koston mbi bazën e çmimit për sipërfaqe ndërtimi. Gjithashtu, kjo vlerë i korrespondon koston së ndërtimit të kryer në vitin 2016, ndërkohë që ndërtimi i këtij objekti ka nisur në vitin 1998 dhe është kryer në vitin 1999, kur çmimi mesatar për sipërfaqe ndërtimi ka qenë 18.740 lekë/m<sup>2</sup>.
31. Në lidhje me konkluzionin për pasaktësi në deklaram lidhur me sipërfaqen reale të objektit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se eksperti që ka vlerësuar pasurinë objekt kontrolli, në hartimin e këtij aktekspertimi është referuar në të dhënat e certifikatës së pronësisë së pasurisë nr. {\*\*\*} të regjistruar në ZVRPP Korçë, me sipërfaqe trualli 170 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 120 m<sup>2</sup>, ku sipërfaqet konkrete të secilit kat nuk janë të pasqyruara në zërin “përshkrim i veçantë”. Gjithashtu subjekti pretendoi se vlera e këtij objekti është përcaktuar sikur ai të ishte i objekt i përfunduar, ndërkohë që, sipas subjektit, vetëm kati i parë është i përfunduar dhe plotësisht funksional, ndërsa dy katet e tjera dhe papafingoja nuk janë të përfunduara (dhe aktualisht jofunksionale), fakt ky që, referuar subjektit, provohet edhe nga fotot e dorëzuara në Komision në cilësinë e provës. Subjekti argumentoi se pasaktësia e ekspertit në aktin e vlerësimit, në mospasjen në vëmendje në përlllogaritjet e tij të vetëm 12,4 m<sup>2</sup>, nuk mund të vlerësohet nga Komisioni si tendencë apo mjet për të fshehur vlerën e saktë të pasurisë, për sa kohë, sipas parashtrimeve të mësipërme, vlera e deklaruar është në fakt një vlerë më e madhe nga ajo sa është faktikisht.
32. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin e Komisionit se sipërfaqja prej 12,4 m<sup>2</sup> në papafingon e objektit është e pambuluar me dokumentacion ligjor dhe pretendoi se, nëse ky konkluzion do të përbënte një fakt të vërtetë, atëherë kjo sipërfaqe do t'i ishte nënshtruar procesit të legalizimit në vitet 2014-2015, pasi jo vetëm do të ishte në interesin e pronarëve të kësaj pasurie, por edhe se përfshirja në këtë proces do të përbënte detyrim nëse kjo sipërfaqe ndërtimore do të konstatohej si sipërfaqe informale nga ALUIZNI. Subjekti pretendoi se në çdo rast një pasaktësi e tillë nga ana e ekspertit, për mospërfshirjen në vlerën e objektit të koston për ndërtimin e një sipërfaqeje prej 12,4 m<sup>2</sup>, nuk mund të përbëjë shkak për të konkluduar se mungon akti ligjor mbi të cilin justifikohet kjo sipërfaqe ndërtimi. Për më tepër që mosmarrja parasysh e kësaj sipërfaqeje ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së të dhënave konkrete mbi sipërfaqet e çdo kati në dokumentacionin e kësaj prone në ZVRPP-në Korçë, por jo se ka mungesë dokumentacioni. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, pretendoi se, ndodhur në këto kushte, konkluzioni i Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm të kësaj pasurie është i pabazuar në ligj pasi ajo nuk

ndodhet në situatën e mosjustifikimit me burime të ligjshme të kësaj pasurie apo që ka tentuar ta fshehtë apo që ka bërë deklaram të rremë të saj.

33. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në mbështetje të shkakut të ankimit për vlerësim të gabuar nga ana e Komisionit të kësaj pasurie të paluajtshme, fillimisht sa i takon vlerës së investimit fillestar për ndërtimin e objektit “pikë karburanti + godinë”, referuar DIPPV-së së vitit 2003, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka deklaruar vlerën prej **10 milionë lekësh** në rubrikën që i takon vlerës së pasurisë së paluajtshme. Ndërkohë, lidhur me këtë deklaram, subjekti në rubrikën e përshkrimit të pasurisë ka bërë shënimin: *{\*\*\*}. Vlefa në milion lekë te kolona e vlefës i përket vlerës së kësaj prone në momentin që bëj këtë deklaram. Viti që është ndërtuar është nëntor 1998 [...].* Ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti ka deklaruar si vlerë të pasurisë së paluajtshme, vlerën prej **15.960.000 lekësh**, për të cilën pretendoi në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj se kjo përfaqëson vlerën e objektit në vitin 2016, referuar aktit të vlerësimit të datës 21.06.2016. Të njëjtin deklaram subjekti ka bërë edhe përpara ILDKPKI-së, në qershor të vitit 2016, kur ka paraqitur edhe aktin e vlerësimit si më sipër cituar. Sa i takon vlerës së investimit fillestar, subjekti ka deklaruar vlerën prej **9.000.000 lekësh** në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe se, referuar ndarjes që u ka bërë subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, kontributeve të saj dhe të bashkëpronarëve të tjerë, rezulton që ajo ka investuar **1.000.000 lekë**. Të njëjtin deklaram bëri subjekti edhe gjatë gjykimit në Kolegj, teksa u pyet nga trupi gjykues lidhur me cilësimin e marrëdhënies së saj me bashkëpronarët e tjerë në raport me vlerën e investimit fillestar për ndërtimin e objektit<sup>12</sup>.
34. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera prej 15.960.000 lekësh përfaqëson vlerën e pasurisë në vitin 2016 dhe jo vlerën e investimit fillestar, pasi dukshëm kjo vlerë korrespondon me vlerën e përcaktuar në aktvlerësimin e përmendur më sipër në vendim dhe është rezultat i përllogaritjeve të kryera mbi bazën çmimeve të miratuara nga EKB-ja për metër katror sipërfaqeje ndërtimi që i korrespondojnë vitit 2016. Ndërkohë që vlera e pasurisë në momentin e krijimit të saj, e cila në fakt duhej të ishte deklaruar në mënyrë të qartë nga ana e subjektit të rivlerësimit në rubrikën e vlerës së pasurisë, konstatohet të jetë deklaruar nga subjekti në formën e kontributeve fillestare të secilit prej bashkëpronarëve për kryerjen e investimit në vlerën totale prej 9.000.000 lekësh. Për rrjedhojë të sa më sipër, referuar këtyre dy deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se mospërputhja e vlerave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit nuk përbën mospërputhje lidhur me vlerën e investimit fillestar, për faktin që në vitin 2003 subjekti është shprehur që 10.000.000 lekë është vlera e objektit në atë vit të deklaramit dhe se ndërtimi është i nëntorit 1998 (duke nënkuptuar që kjo vlerë nuk përbën vlerën e investimit fillestar për ndërtimin e tij në vitin 1998).
35. Trupi gjykues vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në drejtim të deklaramës noteriale të datës 30.06.2000 pranë noterës Zh. I. M., lidhur me qëllimin e vetëm të përpilimit të saj për të përcaktuar pjesët e bashkëpronësisë mbi objektin e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, pa ndikim në vlerën e kontribuuar prej tyre, kjo për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare që i lidhte ata. Edhe pse nga verifikimi i kryer në Kolegj subjekti i rivlerësimit rezultoi të kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar ¼ pjesë të vlerës së investimit fillestar, si rrjedhojë e sa më sipër konkluduar lidhur me vlerën e kontributit fillestar, trupi gjykues çmoi se mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie do duhet të vlerësohet jo vetëm sa i takon kontributit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në vlerën prej 1.000.000 lekësh, por edhe në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të babait të saj, i cili deklarohet prej subjektit të

<sup>12</sup> Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 10.06.2021.

rivlerësimin se ka investuar më shumë dhe, rrjedhimisht, fiton në këtë mënyrë statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si pasojë e dhënies së një kontributi financiar në favor të vajzës së tij, në realizimin e një investimi pa cenuar pjesën takuese të saj.

36. Sa i takon konkluzionit të Komisionit lidhur me pasaktësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimin në deklaratën e pasurisë *vetting* të sipërfaqes reale të objektit, si dhe të vlerës së pasurisë, si pasojë e sipërfaqeve të pasakta, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se konkluzioni i Komisionit sa i takon deklaramit nga subjekti i rivlerësimin të vlerës së pasurisë në rubrikën “Vlera me shifra dhe me numra” nuk duhet trajtuar me efekt në vlerësimin e saktësisë së deklaramit të subjektit lidhur me vlerën e pasurisë objekt kontrolli, për sa kohë kjo vlerë, sipas subjektit, i takon vlerës që ka pasuria në kohën e deklaramit, ndërkohë që vlera e kërkuar në kuadër të procesit të rivlerësimin, por edhe të procesit periodik të deklaramit të pasurisë, është vlera e pasurisë në momentin e krijimit të saj. Vetëm mbi bazën e kësaj vlere vlerësohet në kuadër të këtij procesi ligjshmëria dhe mjaftueshmëria e burimeve financiare të përdorura nga subjekti i rivlerësimin për krijimin e pasurisë dhe vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në një konkluzion të drejtë mbi vlerësimin e saj si pasuri e justifikuar apo jo me burime të ligjshme.
37. Ndërkohë, lidhur edhe me konkluzionin e Komisionit për pasaktësi në deklaramin e sipërfaqes reale të objektit të ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 10.11.1997, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën periodike të vitit 2003, në rubrikën që i takon përshkrimin të pasurisë, subjekti ka deklaruar vetëm llojin e saj, pa bërë deklarime specifike lidhur me katet e objektit dhe sipërfaqen totale të tij apo ato sipas kateve. Vihet re se në këtë formular nuk ka pasur ndonjë kërkesë konkrete për deklarim të hollësishëm të elementeve identifikuese të pasurisë, duke u lënë në diskrecion të subjekteve deklaruese niveli i detajeve të cilat do të deklaroheshin në rubrikën “Përshkrimi”. Megjithatë, vlen të mbahet në konsideratë që subjekti ka deklaruar nr. e regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme në ZVRPP, kur në periudhën në fjalë në vitin 2004, prona figuronte e regjistruar me të dhëna nr. pasurie {\*\*\*}, {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, me sip. totale të pasurisë 170 m<sup>2</sup>, me sip. ndërtese 120 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në rubrikën “Përshkrim i veçantë” shënohet: *Pikë karburanti + dyqan kati 1 dhe 2 kate banimi së bashku me papafingo, sipas projektit të miratuar me lejen nr. {\*\*\*}, datë 10.11.1997.*
38. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Bashkëpronare në ¼ e një sipërfaqeje trualli prej 170 m katror e trashëguar dhe një ndërtesë me sipërfaqe 120 m katror, në katin e parë të së cilës zhvillohet aktivitet për shitje me pakicë të karburantit, vajra etj., ndodhur në lgj. {\*\*\*}, Blv Shëtitore “{\*\*\*}”.* Referuar këtij deklarimi, trupi gjykues konstatoi se me të drejtë subjekti i rivlerësimin, znj. Irma Balli, pretendoi se u është referuar të dhënave zyrtare të regjistrimit të kësaj pasurie të paluajtshme në ZVRPP-në Korçë, por pavarësisht kësaj, ajo kishte detyrimin të deklaronte në mënyrë të hollësishme elementet identifikuese të kësaj pasurie, si: numrin e kateve të saj, sipërfaqet e tyre dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky deklarim i subjektit nuk është i plotë, në përputhje me kërkesat e formularit të deklaramit, megjithatë, në konsideratë të faktit që ky deklarim është shoqëruar nga subjekti me certifikatën për vërtetim pronësie, në cilësinë e dokumentit justifikues në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se mosdeklarimi i këtyre të dhënave nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për deklarim të saktë dhe të plotë. Për më tepër, konstatohet që sipërfaqet e secilit prej kateve të objektit, përveçse nuk shprehen në mënyrë eksplicite në dokumentin e regjistrimit të pronës në ZVRPP Korçë, nuk jepen në vlerën totale të tyre as në planimetritë e secilit prej kateve të banimit të administruara nga ZVRPP Korçë gjatë procesit të regjistrimit fillestar të pronës (edhe pse përmasat paraqiten në

mënyrë të detajuar dhe përlllogaritja e tyre është e mundshme), sikundër ka ndodhur në rastin e papafingos, ku si pasojë e legalizimit të sipërfaqes prej 12,5 m<sup>2</sup>, është evidentuar edhe sipërfaqja totale e këtij kati.

39. Sa i takon konkluzionit të Komisionit se nga analiza e sipërfaqes së papafingos, duke marrë për bazë sipërfaqen totale të ndërtimit për banim, e cila sipas të dhënave të referuara në lejen për legalizim është 132,4 m<sup>2</sup>, rezulton që një sipërfaqe prej 12,4 m<sup>2</sup> është e pajustificuar me dokumentacion ligjor, trupi gjykues vlerësoi se ky konkluzion i Komisionit nuk bazohet në fakte. Trupi gjykues vëren se Komisioni këtë konkluzion të tij nuk e ka bazuar në asnjë informacion apo të dhënë zyrtare nga e cila të provohej, evidentohej apo qoftë edhe të ngrihej ndonjë dyshim mbi mungesën e dokumentacionit justifikues të sipërfaqes në fjalë. Për më tepër, trupi gjykues konstatoi se sipërfaqja prej 12,4 m<sup>2</sup> evidentohet si rezultat i diferencës së sipërfaqes totale të papafingos (prej 144,9 m<sup>2</sup>) me sipërfaqen e legalizuar (prej 12,5 m<sup>2</sup>) dhe me sipërfaqen e katit përdhe (prej 120 m<sup>2</sup>), sipërfaqja e të cilit përcakton dhe njollën e ndërtimit prej 120 m<sup>2</sup>. Kjo mënyrë përlllogaritjeje, mbi bazë krahasimi të sipërfaqes së papafingos me atë të katit përdhe, vlerësohet të jetë e gabuar, sa kohë referuar planimetrive të objektit të administruara nga ZVRPP Korçë, mbi bazë të të cilave është kryer dhe regjistrimi fillestar i objektit, sipërfaqet e kateve të tjera konstatohen se kanë një avancim në raport me katin përdhe, i cili e ka sipërfaqen 120 m<sup>2</sup>, duke bërë që sipërfaqet e kateve të mësipërme të jenë më të mëdha se 120 m<sup>2</sup> (ky konstatim konfirmohet me sy të lirë edhe nga fotot e objektit të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision). Sa më sipër shpjegon dhe faktin se gjatë procedurës për legalizimin e shtesës prej 12,5 m<sup>2</sup> në papafingon e objektit, ALUIZNI nuk e ka konstatuar sipërfaqen prej 12,4 m<sup>2</sup> të pajustificuar me dokument ligjor, pasi kjo situatë është evidente në projektin e miratuar sipas lejeve përkatëse të vitit 1997.
40. Në përfundim, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se paqartësitë lidhur me sipërfaqen totale të objektit vijnë si pasojë e faktit që ato nuk gjejnë pasqyrim të cilësuar në kartelën e pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Edhe pse trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimeve që i lindnin nga procesi i rivlerësimit kalimtar, duhet të kishte bërë përpjekje për të identifikuar këtë të dhënë të kërkuar, në vlerësimin tërësor të rrethanave në të cilat kanë ndodhur faktet, kjo situatë nuk vlerësohet në dëm të subjektit të rivlerësimit, sa kohë nuk provohet se kjo situatë ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo qoftë edhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

*iii) Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë së paluajtshme "pikë karburanti + ndërtesë"*

41. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me burimin/et e krijimit të pasurisë objekt kontrolli si vijon: *Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave nga puna në emigracion e bashkëshortit, të deklaruar si një nga burimet financiare në deklaratën e pasurisë - shtojca 2, për ndërtimin e pasurisë "Karburant dhe godinë 3 kate + papafingo".*  
*Deklarimi nga ana e subjektit se nuk disponon dokumentacion që të provojë punësimin e bashkëshortit si emigrant në Greqi, nuk e mundëson zbatimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sepse subjekti nuk ka provuar që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dhe për të disponuar një dokument justifikues. [...]*  
*Komisioni konstatoi se shitja e apartamentit është kryer pas përfundimit të ndërtimit të objektit "Pikë karburanti" dhe pas kolaudit të tij dhe, për rrjedhojë, shuma e përfituar nga shitja e apartamentit nuk mund të ketë shërbyer si burim të ardhurash të ligjshme për të justifikuar investimin prej 1 milionë lekë të znj. M. S. në ndërtimin e objektit. Bazuar në aktmarrëveshjen nr.*



{\*\*\*}, datë 08.06.1998, e lidhur ndërmjet katër bashkëpronarëve dhe shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, konfirmohet fakti se investimi për vazhdimin dhe përfundimin e ndërtimit pas kësaj date është kryer nga shoqëria dhe jo nga bashkëpronarët. Në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 21 të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*}, datë 10.10.2016, subjekti nuk arriti të provojë ekzistencën e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar investimin prej 1.000.000 lekësh të znj. M. S. në ndërtimin e objektit në fjalë.

[...] Komisioni vlerëson se në kuptim të pikës 3 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ekzistenca dhe ligjshmëria e burimit të krijimit të shumës monetare prej 3.500.000 lekësh, e investuar nga babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, për ndërtimin e objektit, nuk është e provuar me dokumentacion ligjor.

Nuk provohet me dokumentacion ligjor dërgimi dhe posedimi ndër vite i shumave monetare që sipas pretendimeve të subjektit, nga shtetasi P. R. janë dërguar nga SHBA-ja në Shqipëri, për llogari të shtetasit N. R., për më tepër që z. P. R., ka vdekur në vitin 1962 dhe nuk është bindës shpjegimi që prej vitit 1962 mund të jenë kursyer dhe mbartur për më shumë se 30 vjet shuma të tilla parash, duke pasur parasysh edhe rrethanat sociale, politike dhe ekonomike të atyre viteve. Gjithashtu, rezulton i pamundur krijimi i kursimeve nga të dy prindërit e subjektit nëpërmjet të ardhurave të tyre nga puna, për faktin se prej vitit 1993, të dy ata kanë qenë në pension dhe se pensionet në Republikën e Shqipërisë kanë qenë në vlera minimale për të mundësuar përballimin e shpenzimeve jetike. Subjekti nuk ka vërtetuar me dokumentacion ligjor punësimin dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe kursimeve të vëllait të saj nga punësimi si emigrant në Greqi.

42. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kryer mbi ligjshmërinë e burimit/eve financiar/e për realizimin e investimit fillestar nga subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkëpronarët e tjerë, përkatësisht z. A. R. (babai i subjektit të rivlerësimit, njohur edhe si N. R.), P. R. (i vëllai) dhe M. S. (K.) (e motra). Sa u takon burimeve financiare të përdorura nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, kjo e fundit pretendoi se Komisioni në mënyrë të gabuar ka arritur në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit nuk justifikon investimin në fjalë, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues lidhur me punësimin e bashkëshortit në Greqi, kur është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe sqaruar në pyetësorin e dt. 29.10.2018, se të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit nuk janë burimi i vetëm apo ai kryesor i të ardhurave të përdorura për kryerjen e këtij investimi. Subjekti pretendoi gjithashtu se në periudhën kur është kryer ky investim prej saj, ajo dhe bashkëshorti i saj kishin kursime të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e këtij investimi. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim, si dhe në qëndrimin e mbajtur para trupit gjykues në Kolegj, se Komisioni nuk e ka pyetur gjatë hetimit administrativ se sa ka qenë vlera e investuar me burim nga emigracioni. Sa i takon çështjes së dokumentacionit justifikues lidhur me të ardhurat me burim emigracionin, subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë absolute për të sjellë dokumentacion që u takon të ardhurave të krijuara nga punësimi i bashkëshortit të saj në vitet 1992-1993, në ishullin e Kretës, Greqi, përveçse dorëzimit të disa korrespondencave dhe fotove të bashkëshortit të saj, të asaj periudhe, për të cilat kërkoi nga Kolegji që të administrohen në cilësinë e provave të reja.
43. Sa u takon bashkëpronarëve të tjerë në këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke trajtuar si *persona të tjerë të lidhur* babain, motrën dhe vëllain e saj në lidhje me investimin e kryer për ndërtimin e një pike karburanti dhe godinën në krah, ndërkohë që ata janë *persona të tjerë të lidhur* sipas kësaj dispozite vetëm në lidhje me dhurimin prej tyre të ¼ pjesë të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 170 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është kryer investimi në fjalë. Subjekti pretendoi se në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe nënligjore, asaj i është kërkuar të justifikojë burimin e

të ardhurave nga emigracioni për gjyshin<sup>13</sup> dhe vëllain e saj. Sipas subjektit, Komisioni në këtë rast ka shkelur dhe dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale sa i takon hetimit në drejtim të personave të cilët janë jashtë rrethit të personave të lidhur (familjes bashkëjetuese). Pavarësisht sa më sipër, subjekti i rivlerësimit shprehet në ankim se, në përmbushje të kërkesave të deklaratës së pasurisë, ka deklaruar bashkëpronarët e tjerë të pasurisë objekt kontrolli, si dhe burimet e të ardhurave të tyre që kanë shërbyer për kryerjen e investimit fillestar. Gjithashtu subjekti pretendoi se Komisioni në mënyrë të gabuar dhe të pabazuar ka arritur në konkluzionin që tre bashkëpronarët e tjerë nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pjesën e tyre të pasurisë në bashkëpronësi.

44. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionin e arritur nga Komisioni, sa i takon fillimisht justifikimit të burimit të të ardhurave nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi, trupi gjykues nënvizon se Kolegji tashmë ka jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të fakteve të cilat do duhet të provohen, me qëllim që të justifikohen si të ardhura të ligjshme dhe, për rrjedhojë, të shërbejnë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të ardhurat me burim emigracionin e subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të. Në kuadër të qëndrimeve të mëparshme të Kolegjit lidhur me këtë çështje, të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit (të paidentifikuara në vlerë), me burim emigracionin e bashkëshortit në Greqi, nuk provohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar niveli i këtyre të ardhurave, fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, si dhe dërgesa e tyre nga vendi i origjinës në Shqipëri, edhe në rast se, eventualisht, korrespondencat dhe fotot e sjella nga subjekti pranohen si prova të faktit të punësimit të bashkëshortit në shtetin grek, në periudhën e deklaruar.
45. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, pasi verifikoi aktet e fashikullit të përcjellë nga Komisioni, konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për krijimin e pjesës takuese të investimit fillestar: *Në investimin fillestar unë kam kontribuar me 1.000.000 lekë që janë kryesisht pjesë e kursimeve dhe nga puna e A. (bashkëshortit si emigrant)*. Ndërsa në DIPPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim: *kursimet familjare dhe fitimet e realizuara nga shitja e karburantit (kjo e fundit lidhet me shlyerjen e investimit ndaj shoqërisë {\*\*\*} ShPK)*. Në të njëjtën deklaratë periodike, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e krijuara nga emigracioni në Greqi për vitet 1993, 1994, si burim për blerjen e një automjeti tip “Benz”.
46. Në përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga Komisioni, depozituar më datë 29.10.201...<sup>14</sup>, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, lidhur me pyetjen për të sqaruar burimin e shumave të investuara nga secili prej bashkëpronarëve të pikës së karburantit, lidhur me investimin e saj, është shprehur: *Investimi i familjes sime, në vlerën 1.000.000 lekë, për ndërtimin e pikës së karburantit, e ka pasur burimin te kursimet nga të ardhurat e punës sime dhe të bashkëshortit. Shpjegoj se, ashtu siç dhe ju kam dërguar informacionet përkatëse, të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit, vetëm për periudhën e viteve 1987-2000, janë në masën 3.411.810 lekë. Këto të ardhura të ligjshme justifikojnë kursimin tonë në masën 1.000.000 lekë, për ta investuar në ndërtimin e pikës së karburantit. Po përmend vetëm vlerën e të ardhurave tona për periudhën 1987-2000, pa përmendur kursimet nga puna e bashkëshortit tim në Greqi në vitet 1992-1993 (siç kam deklaruar në deklaratën për “vetting”).*

<sup>13</sup> Të ardhura këto të pretenduara se janë përdorur nga babai i subjektit të rivlerësimit për realizimin e investimit.

<sup>14</sup> Nuk rezultoi të jetë vënë shënim viti nga zyra e protokollit, por logjikisht bëhet fjalë për vitin 2018.

47. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se burimi i investimit fillestar në ndërtimin e pikës së karburantit në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në formën e tërësisë së burimeve të disponueshme në atë periudhë, ndërkohë bie në sy fakti që në DIPPV-në e vitit 2003, burimet e përdorura për pasuritë e krijuara deri në deklarimin e parë janë individualizuar, ku konstatohet se të ardhurat nga emigracioni janë deklaruar se kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” dhe jo për investimin për ndërtimin e pikës së karburantit.
48. Në vlerësim të trupit gjykues, deklarata e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, përfaqëson deklarimin më të afërt në aspektin kohor lidhur me momentin kur është krijuar pasuria objekt kontrolli, në drejtim të identifikimit të burimeve të përdorura për kryerjen e investimit fillestar për ndërtimin e pikës së karburantit. Në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, mes deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratës periodike të vitit 2003, deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk krijojnë kundërshti lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se Komisioni vlerësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*, sa i takon përcaktimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, duhet ta kishte kryer të lidhur me deklaratën periodike të vitit 2003, në përputhje edhe me parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
49. Në vijim të arsytimit të mësipërm, nga verifikimet e kryera në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor lidhur me mundësinë e financimit me burime të ligjshme të ndërtimit të “pikës së karburantit dhe godinës 3 kate + papafingo”, trupi gjykues, pasi mori në analizë burimin primar të deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting* (kursimet nga të ardhurat e realizuara nga punësimi në Republikën e Shqipërisë, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, për periudhën kohore deri në vitin 1999), sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit në Komision, si dhe shpenzimet e jetesës të përlllogaritura në masën e 30% të këtyre të ardhurave, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, deri në vitin 1999, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e investimit fillestar të pasurisë “karburant dhe godinë 3 kate + papafingo” në vlerën e 1.000.000 lekëve.
50. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për zbatim të gabuar nga ana e Komisionit të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të trajtimit të tre bashkëpronarëve të tjerë, përkatësisht z. A. R., z. P. R. dhe znj. M. S. (K.) si *persona të tjerë të lidhur* me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se edhe pse Komisioni nuk i ka cilësuar ata në mënyrë të shprehur si *persona të tjerë të lidhur* në kuadër të parashikimeve të nenit të sipërcituar, i ka trajtuar ata sipas kësaj dispozite ligjore në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të tyre për kryerjen e investimit të përbashkët për ndërtimin e objektit pikë karburanti, në tokën truall në bashkëpronësi me ¼ pjesë, dhe i ka atribuuar subjektit të rivlerësimit pasojën e të mosprovuarit për secilin prej tyre të ligjshmërisë së burimit për kryerjen e investimit.
51. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim marrëdhënien e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe tre bashkëpronarëve të tjerë në drejtim të investimit për kryerjen e ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli, në konsideratë edhe të konkluzionit të arritur në paragrafin 35 më sipër në vendim lidhur me raportin e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj, të ndjerit A. R., si pasojë e kontributit të këtij të fundit në mbulimin e një pjese të investimit që i takonte subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin që vetëm babai do duhet të ishte cilësuar nga ana e Komisionit si *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, t’i nënshtrohej zbatimit të tij. Ndërsa sa u takon dy bashkëpronarëve të tjerë, vëllait dhe motrës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në konkluzionin që trajtimi i tyre nga ana e Komisionit në cilësinë e *personave të tjerë të lidhur* është

i pabazuar në ligj, në kushtet kur personat e sipërcituar, në ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, janë bashkinvestitorë dhe kur kjo marrëdhënie interesi pasuror mes tyre nuk përfshihet në gamën e marrëdhënieve të përcaktuara shprehimisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do të justifikonte cilësimin e tyre si *persona të tjerë të lidhur* me subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit në këtë drejtim, në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni ka gabuar në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve për kryerjen e investimit nga ana e tyre, për sa kohë, nga hetimi administrativ, nuk rezultoi asnjë gjetje mbi bazën e së cilës të mund të ngriheshin dyshime të arsyeshme në lidhje me përfshirjen reale të këtyre personave në investim, d.m.th. dyshime për fshehje nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, të pasurisë së saj në emër të këtyre familjarëve.

52. Në vijim të arsytimit të mësipërm, si dhe përfundimit të arritur në lidhje me statusin e babait të subjektit të rivlerësimit si *person tjetër i lidhur* me të, për shkak të kontributit të tij në mbulimin e një pjese të investimit, në vlerën prej 375.000 lekësh, që i takonte subjektit të rivlerësimit në kuadër të pjesëmarrjes së saj me ¼ pjesë të investimit, nga verifikimi i kryer nga ana e Njësisë së Shërbimit Ligjor, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit dhe atij të pranuar në cilësinë e provës gjatë gjyqimit në Kolegj, rezultoi se nuk u arrit të provohet që babai i subjektit të rivlerësimit justifikonte me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e burimeve të përdorura si kontribut në vlerën prej 375.000 lekësh, në favor të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar vlerën prej 375.000 lekësh, pjesë e investimit fillestar të kryer për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, në të cilën është bashkëpronare me ¼ pjesë të saj.

*iv) Lidhur me sipërfaqen shtesë prej 12,5 m<sup>2</sup> të papafingos, të legalizuar në vitin 2015*

53. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsytuar në vendimin e tij, lidhur me sipërfaqen shtesë prej 12,5 m<sup>2</sup> të papafingos, të legalizuar në vitin 2015, si vijon: *Ndërtimi pa leje i shtesës anësore nga subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë, në bazë të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, "Për urbanistikën", është parashikuar si kundërvajtje administrative dhe nuk përbën vepër penale në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e ndërtimit. Sipërfaqja ndërtimore e përcaktuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2011, është 120 m<sup>2</sup>. Sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2015, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 132,4 + 12,5 m<sup>2</sup>, ku sipërfaqja e shtesës së legalizuar është 12,5 m<sup>2</sup>. Për sa më sipër, rezultojnë: Mosdeklarim i sipërfaqes së legalizuar prej 12,5 m<sup>2</sup> në vitin e ndërtimit të saj. Mosdeklarim i sipërfaqes reale të papafingos në deklaratën e pasurisë - shtojca 2, ku përveç sipërfaqes së legalizuar prej 12,5 m<sup>2</sup>, rezultojnë edhe 12,4 m<sup>2</sup> të pajustificuara me dokumentacion ligjor, për rrjedhojë kemi të bëjmë me një deklarim të pamjaftueshëm.*
54. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, si pasojë e mosdeklarimit të sipërfaqes së legalizuar prej 12,5m<sup>2</sup> në vitin e ndërtimit, si dhe mosdeklarimit të sipërfaqes reale të papafingos në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në mbështetje të këtij shkakut të ankimit, subjekti argumentoi se kjo sipërfaqe shtesë është deklaruar në vitin 2015, kur dhe është marrë titulli i bashkëpronësisë mbi këtë shtesë, çka përbën zyrtarisht shtimin e kësaj pasurie me titull të ligjshëm. Subjekti pretendoi se ky fakt nuk është deklaruar në vitin e ndërtimit, pasi shpenzimet për këtë ndërtim kanë qenë të papërfillshme dhe jashtë vlerës së kërkuar në formular lidhur me shpenzimet e deklarueshme. Subjekti pretendoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, është e vërtetë që nuk ka deklaruar sipërfaqet konkrete të kateve, porse ka referuar te numri i pasurisë së paluajtshme sipas regjistrimit të saj në ZVRPP, si dhe ka deklaruar bashkëpronarët e tjerë të kësaj pasurie, sipas gjendjes së tyre në

dokumentin e regjistrimit të pronës. Gjithashtu, subjekti shprehet se deklarin lidhur me këtë pasuri e ka shoqëruar pikërisht me këtë dokument në cilësinë e provës, me certifikatën e pronësisë të datë 27.07.2016, bazuar dhe në udhëzimin e ILDKPKI-së të datës 10.10.2016.

55. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se, sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2015, për objektin shtesë anësore e papafingos (kati i tretë) në objekt të regjistruar, sipërfaqja e legalizuar sipas akteve bashkëlidhur, pas verifikimeve të kryera në terren nga ana e specialistëve të ALUIZNIT, si dhe krahasimit të matjeve të terrenit me dokumentacionin zyrtar të pasurisë objekt legalizimi, rezultoi të jetë 12,5 m<sup>2</sup>, dhe sipërfaqja e papafingos nga 132,4 m<sup>2</sup> bëhet 144,9 m<sup>2</sup>. Këtë sipërfaqe të legalizuar subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DIPPV-në e vitit 2015, si shtesë sipërfaqeje në papafingon e pronës së deklaruar (karburant + ndërtesë), të regjistruar me nr. pronësie {\*\*\*}, sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 22.12.2015, dhe me pjesë takuese 25%.
56. Referuar legjislacionit në fuqi për deklarin e pasurive dhe interesave privatë, subjektet deklaruese në deklarin periodik të tyre duhet të deklarojnë shtesat dhe pakësimet në pasuritë e tyre, krahasuar me deklarin e mëparshëm. Në kuadër të këtij parashikimi ligjor, trupi gjykues çmoi se për efekt të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, shtrohet për diskutim çështja nëse shtesa me sipërfaqe<sup>15</sup> 12,5 m<sup>2</sup>, e cila nuk përbënte ende një pasuri të ligjshme<sup>16</sup> në vitin 2008, konsiderohej apo jo në këtë vit si shtesë pasurie.
57. Nga vlerësimi i kuadrit ligjor të kohës në të cilën kanë ndodhur faktet objekt analize, trupi gjykues vlerësoi se subjekti me të drejtë ka kryer deklarin e kësaj shtese anësore me sip. 12,5 m<sup>2</sup> në ndërtesë me leje, në deklaratën periodike vjetore që i përkiste vitit të legalizimit të saj, pasi nga ky moment<sup>17</sup> e në vijim subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, dhe 3 familjarët e saj janë bërë bashkëpronarë në ¼ pjesë të pandarë të pasurisë së tyre tashmë të shtuar me këtë sipërfaqe ndërtimi të legalizuar. Në të njëjtën linjë me këtë interpretim është edhe kërkesa specifike në formularët e deklarin periodik, sipas së cilës subjektet deklaruese duhet të deklarojnë hollësisht ndryshimet (shtesat dhe pakësimet) lidhur me çdo lloj pasurie të tyre, të luajtshme, të paluajtshme apo në formën e likuiditeteve, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, që u referohet rasteve kur subjektet kanë fituar titullin e pronësisë mbi një pasuri të caktuar, edhe pse ndodhen ende në fazën e mosregjistrimit të saj (nëse është rasti) në regjistrat publikë. Pikërisht në këtë linjë është nxjerrë dhe udhëzimi i Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2016, sipas të cilit parashikohet shprehimisht në pikën 8: *Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerjeje, kontratë sipërmarrjeje, aktmarrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP.*

<sup>15</sup> Sipas subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e dhëna lidhur me pyetësorin e Komisionit në datën 10.09.2018, kjo sipërfaqe i referohet sipërfaqes së shtuar në papafingo si pasojë e ngritjes së një muri. Më konkretisht, subjekti ka deklaruar: "Lidhur me shtesën anësore në papafingo, për të cilën është deklaruar pranë ALUIZNIT dhe është marrë vendimi i legalizimit, sqarohet se: Që në fazën e ndërtimit të objektit (1998-1999) është kryer një gabim konstruktiv në soletën e papafingos dhe në verën e vitit 2008 ky gabim u korrigjua nëpërmjet ngritjes së një muri, investimi për të cilin ishte fare minimal".

<sup>16</sup> Neni 76 i ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar, parashikonte shprehimisht: Ndërtimet e bëra pa leje ndërtimi janë të kundërligjshme.

Ndalohet hipotekimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

<sup>17</sup> Referuar ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 3, germa "gj", "Leje legalizimi" është dokumenti, që lëshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj nga zyra përkatëse e ALUIZNI-t dhe që shërben për regjistrimin e objektit në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

58. Ndërkohë që pasuritë në proces legalizimi pranë ALUIZNIT trajtohen veçmas në pikën 9 të të njëjtit udhëzim, sipas të cilit deklarimi i tyre në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar duhet të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë ALUIZNIT. Kjo pikë e udhëzimit lidhet konkretisht me pasuritë të cilat në momentin e deklarimit, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, janë në posedim apo përdorim të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, kërkesë kjo e cila ndryshe nga detyrimi për deklarim periodik, është përcaktuar për herë të parë në procesin e rivlerësimit kalimtar, në zbërthim të parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të sipërfaqes së legalizuar të papafingos në vitin 2008, nuk është i bazuar në ligj. Sa i takon shpenzimit të kryer nga bashkëpronarët për ndërtimin e murit i cili ka mundësuar shtesën e sipërfaqes prej 12,5 m<sup>2</sup>, në vlerën monetare prej 146.000 lekësh<sup>18</sup>, trupi gjykues, pasi verifikoi legjislacionin e zbatueshëm për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, konstatoi se subjekti i rivlerësimit në vitin 2008, kur dhe ka ndodhur ky ndërtim pa leje (referuar formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNIT, si dhe pohimit të subjektit në seancën e datës 10.06.2021 gjatë gjykimit në Kolegj), nuk ndodhej në kushtet e detyrimit për deklarim të këtij shpenzimi, për sa kohë detyrimi për deklarim i shpenzimeve të kryera në masën e caktuar nga ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2012.
59. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj edhe konkluzionin tjetër të Komisionit për mosdeklarimin e sipërfaqes totale të papafingos në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi, referuar legjislacionit të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar, subjekti nuk kishte detyrim të posaçëm për të deklaruar sipërfaqen e papafingos, për sa kohë ky kat, në momentin e deklarimit nuk ishte në proces legalizimi dhe, për rrjedhojë, kjo pjesë e pasurisë në bashkëpronësi të subjektit nuk i nënshtrohej ndonjë regjimi të posaçëm deklarimi, përveçse të trajtohej si pjesë integrale e pasurisë “pikë karburanti + ndërtesë” dhe të deklarohet si e tillë, me konsideratat që janë dhënë më sipër në vendim.
60. *Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë “pikë karburanti” me adresë në Bulevardin “{\*\*\*}”, Korçë, në periudhën 2011-2014, për të cilat subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar vlerësimin e Komisionit për paligjshmëri të këtyre të ardhurave, me arsyetimin se për një pjesë të tyre nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
61. Komisioni, në kuadër të analizës mbi verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga dhënia me qira e pikës së karburantit, ka arsyetuar në vendim: *Nga analiza e kontratave, rezulton se në kontratat e lidhura me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, detyrimin e pagimit të tatimit mbi qiratë e ka qiradhënësi, ndërsa me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, sipas kontratës së qirasë, qiramarrësi do të zbresë nga shuma e qirasë mujore çdo tatim të aplikueshëm mbi të ardhurat personale nga qiraja që lindin si detyrim qiradhënësit, ose çdo mbajtje në burim, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në momentin e kryerjes se pagesës, duke e mbajtur atë në burim dhe derdhur pranë organeve tatimore përkatëse. Nga informacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës informon se për tatimpaguesin “{\*\*\*}” ShPK, nuk ka kontrata për qiranë dhe asnjë dokumentacion të saktë për llogaritjen e detyrimeve sipas kontratave, ndërsa Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj dërgon informacion mbi pagesat e qirasë për vitet 2010 dhe 2011, si dhe për disa muaj në vitin 2014, por pa specifikuar se për cilat qira janë kryer këto pagesa. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2018, dërgon informacionin se subjektit “{\*\*\*}” ShPK i është kontrolluar dhe rivlerësuar deklarata e tatimit në*

<sup>18</sup> Shih përgjigjen e subjektit lidhur me pyetjen nr. 3, në materialin e depozituar në Komision më datë 29.10.2018.

*burim për rubrikën "Pagesat për qiratë" për periudhën e mësipërme në dhjetor 2014, dhe ka dalë me detyrim për të paguar në shumën 4.570.250 lekë. Subjekti nuk e ka paguar këtë detyrim.*

*Për subjektin "{\*\*\*}" ShPK, është përcjellë informacioni se ka deklaruar deklaratën e tatimit në burim për periudhën dhjetor 2014 - nëntor 2016, në rubrikën pagesat për qiratë dhe ka paguar shumën 33.792.188 lekë. Pagesat e kryera nga shoqëria janë në total për të gjitha objektet me qira dhe nuk mund të specifikohen pagesat e tatimit në burim për kontratat.*

*Komisioni konstatoi se, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, nuk vërtetohet pagesa e plotë e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e objektit "pikë karburanti", sipas kontratave të qirasë dhe të dhënave bankare.*

*Kjo sjell si pasojë që analizat financiare për vitet 2011, 2013 dhe 2014, pas rezultateve të hetimit dhe shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit, të rezultojnë si më poshtë<sup>19</sup> [...].*

62. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni u ka bërë të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i qiradhënies së pikës së karburantit të shoqërive të ndryshme tregtare që kanë ushtruar aktivitetin e shitjes me pakicë të karburantit, ka ngritur pretendimin se Komisioni ka gabuar në vlerësimin si të paligjshme të një pjese të këtyre të ardhurave të krijuara nga qiradhënia e pikës së karburantit në periudhën 2011-2014, me arsyetimin se për disa prej pagesave të qirasë nuk u provua që për këto vlera të jetë përmbushur detyrimi i pagimit të tatimit në burim, pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin kur qiramarrësi është subjekt tregtar ligji ngarkon atë, me mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja dhe derdhjen e tyre në buxhetin e organit tatimor përkatës, në cilësinë e agjentit tatimbledhës.

63. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, parashtroi në ankimin e saj, si dhe gjatë parashtresës në Kolegj se shoqëritë qiramarrëse nuk kanë qenë korrekte në shlyerjen e detyrimeve të tyre kontraktuale lidhur me pagesën e çmimit të qirasë mujore dhe se në disa raste kanë kryer pagesa të cilat korrespondojnë me vlerën bruto të qirasë, ndërsa për disa muaj të tjerë në vijim nuk kanë kryer asnjë pagesë qiraje në kompensim të mbajtjes së detyrimit. Megjithatë, përtej këtyre parregullsive, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me kontratat e qirave të lidhura me shoqëritë "{\*\*\*}" ShPK dhe "{\*\*\*}" ShPK, pretendoi se në total, në cilësinë e palës qiradhënëse, kanë përfituar një vlerë totale të qirasë edhe më të vogël se vlera neto që i korrespondon parashikimit kontraktual, duke parashtruar konkretisht:

**63.1.** *Bazuar në kontratën e qirasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.03.2011, me shoqërinë "{\*\*\*}" ShPK, detyrimi i kësaj shoqërie ndaj nesh, sipas kontratës, nga muaji prill 2011 deri në muajin korrik 2013 ka qenë në masën 9.800.000 lekë. Vlera e detyrimit tatimor ka qenë në masën 980.000 lekë. Nga kjo shoqëri realisht janë derdhur në favorin tonë 8.610.000 lekë, në një kohë që detyrimi që duhej të derdhte, pas mbajtjes së masës së tatimit, ka qenë 8.820.000 lekë.*

**63.2.** *Bazuar në kontratën e qirasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me shoqërinë "{\*\*\*}" ShPK, detyrimi i kësaj shoqërie ndaj nesh, për periudhën gusht 2013 deri në tetor 2014, ka qenë në masën 4.600.000 lekë. Vlera e detyrimit tatimor sipas ligjit është në masën 460.000 lekë. Nga statement-et bankare, rezulton se nga shoqëria "{\*\*\*}" janë derdhur në favorin tonë 4.087.000 lekë, në një kohë që detyrimi real neto i kësaj shoqërie për të derdhur në favorin tonë, në respektim të marrëveshjes, ka qenë 4.140.000 lekë.*

---

<sup>19</sup> Duke iu referuar tabelave në të cilat paraqitet efekti i mospërfshirjes së një pjese të këtyre të ardhurave në analizën të ardhura-shpenzime për vitet 2011, 2013 dhe 2014.

64. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku të ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili lidhet me çështjen e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia e pikës së karburantit, trupi gjykues çmoi me rëndësi në kuadër të vendimmarrjes së tij, trajtimin e disa aspekteve juridike të cilat lidhen me përcaktimin e qartë të detyrimeve që i burojnë qiradhënësit të pasurisë së paluajtshme në raport me të ardhurat e krijuara nga qiradhënia, vlerësuar këto në kuadër të parashikimeve kontraktuale dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi. Për efekt të kësaj analize, trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të çështjes, konstatoi sa më poshtë.
65. Subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkëpronarët e tjerë, në cilësinë e qiradhënësit të pasurisë së paluajtshme pikë karburanti, kanë lidhur një kontratë qiraje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, të përfaqësuar nga z. A. B., me qira mujore 350.000 lekë në muaj, për një kohëzgjatje 5-vjeçare, duke filluar nga data 02.04.2011. Kjo kontratë është lidhur para noterit publik A. Xh. R. me nr. {\*\*\*} rep., nr {\*\*\*} kol., datë 17.03.2011. Rezulton që kontrata të jetë ndërprerë para afatit, sipas marrëveshjes së palëve. Në vijim, pala qiradhënëse ka lidhur një tjetër kontratë qiraje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, të përfaqësuar me prokurë nga i njëjti person, z. A. B., me qira mujore, vlera e së cilës ndryshon sipas përcaktimeve në nenin 5 të kontratës. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar për 5 vite duke filluar nga data 01.08.2013. Kjo kontratë është lidhur para noterit publik M. D. me nr. {\*\*\*} rep., nr {\*\*\*} kol., datë 17.03.2011. Edhe kjo kontratë rezulton të jetë ndërprerë para afatit, sipas marrëveshjes së palëve.
66. Më datë 20.10.2014, subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkëpronarët e tjerë, në cilësinë e qiradhënësit të pasurisë së paluajtshme pikë karburanti, kanë lidhur një kontratë të re qiraje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, të përfaqësuar nga z. G. G., me qira mujore në vlerën 388.889 lekë, përfshirë këtu 10% tatimin në burim dhe çdo tatim tjetër nëse është i aplikueshëm. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar për një periudhë 5-vjeçare. Kjo kontratë është lidhur para noterit publik D. Ç. me nr. {\*\*\*} rep., nr {\*\*\*} kol., datë 20.10.2014.
67. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre kontratave, sa u takon detyrimeve lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga qiraja, trupi gjykues konstatoi se në dy kontratat e para të qirasë, ato me shoqëritë “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, të cilat në marrëdhënien e tyre me palën qiradhënëse janë përfaqësuar nga i njëjti person z. A. B., përcaktimi lidhur me detyrimin e palës qiradhënëse është pothuajse i njëjtë, i formuluar përkatësisht si vijon: *(sipas kontratës me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK) – Qiradhënësi është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet fiskale ndaj shtetit deri në momentin e marrjes në dorëzim të pikës nga qiramarrësi përveç tatimit mbi fitimin (10% i cili është detyrim i qiradhënësit). (Sipas kontratës me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK) – Qiradhënësi është i detyruar të paguajë detyrimet fiskale përkatëse ndaj shtetit, që i takojnë në lidhje me qiradhënien, si dhe mbi pasurinë e paluajtshme, në bazë të nenit 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore (i ndryshuar) etj.*
68. Ndërkohë që në kontratën e qirasë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK përcaktohet se qiramarrësi do të zbresë nga shuma e qirasë mujore çdo tatim të aplikueshëm mbi të ardhurat personale nga qiraja që lind si detyrim qiradhënësit, ose çdo mbajtje në burim në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në momentin e kryerjes së pagesës, duke e mbajtur atë në burim dhe derdhur pranë organeve tatimore përkatëse. Sipas parashikimit të mësipërm kontraktual, palët kanë përcaktuar shprehimisht se qiraja mujore e përcaktuar në nenin 3, pika 3.01 dhe shumat e tjera të përcaktuara në nenin 3, pika 3.02, përfshijnë vlerën e këtij tatimi.
69. Në shqyrtim të këtyre parashikimeve kontraktuale, në dukje të ndryshme, trupi gjykues çmoi me rëndësi kryerjen e një analize juridike lidhur me kuadrin ligjor të kohës që normonte çështjet e



pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, me qëllim interpretimin e duhur të parashikimeve të sipërcituara kontraktuale. Sipas legjislacionit të analizuar, rezulton se:

**69.1.** Në nenin 8, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” përcaktohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme edhe të ardhurat nga qiraja, për rrjedhojë edhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëpronarëve të tjerë në rastin konkret i nënshtrohen detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale.

**69.2.** Sipas nenit 33, pika 1, germa “ë” e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, deri në kohën e lidhjes së kontratave të qiradhënies, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të përcaktuara shprehimisht në këtë nen, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, ndër to edhe nga marrëdhënia e qirasë.

**69.3.** Në nenin 35 të të njëjtit ligj sa më sipër cituar, përcaktohet detyrimi i mbajtjes dhe regjistrimit të tatimit në burim, si vijon: *Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit të parashikuar në nenet 33 dhe 34 të këtij ligji, derdh tatimin e mbajtur në llogaritë e organeve tatimore jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës të muajit të pagesës. Paguesi i këtyre shumave duhet të nxjerrë pagesat e përfitimeve dhe mbajtjen në burim të tatimeve dhe t'ua verë në dispozicion organeve tatimore, si dhe personit, për të cilin është bërë pagesa, regjistrimet përkatëse.*

**69.4.** Në nenin 7 të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit, parashikohet shprehimisht se agjenti i mbajtjes së tatimit ka, ndër të tjera, edhe detyrë për të llogaritur saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues, si dhe të paguajë tatimin në burim në buxhetin e shtetit, në datën e përcaktuar në ligj.

**70.** Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se pavarësisht se në dy kontratat e lidhura me subjektet “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, në përmbajtje të tyre përcaktohet rregulli i përgjithshëm që qiradhënësi i nënshtrohet detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurën e përfituar nga qiraja, e cila me të drejtë, referuar parashikimit të nenit 8 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale përbën një burim të tatueshëm të ardhurash, ky parashikim nuk mund të interpretohet se detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në buxhetin e shtetit, në masën e përcaktuar nga ligji mbi vlerën bruto të qirasë, e ka qiradhënësi, për sa kohë, referuar kuadrit të sipërcituar ligjor, ky përbën një detyrim ligjor të dy shoqërive qiramarrëse në rastin objekt gjykimi, të cilat ligji i ka përcaktuar si agjentë të mbajtjes së tatimit në burim dhe u ka ngarkuar detyrimin ligjor për të llogaritur në mënyrë të saktë masën e detyrimit tatimor dhe mbajtjen e këtij detyrimi në burim, si dhe pagimin e tij në buxhetin e shtetit në afatin e përcaktuar me ligj.

**71.** Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, konstatoi se pagesat e qirave nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK për periudhën prill 2011 deri në prill 2013, janë derdhur në vlera që u korrespondojnë secila pagesave mujore ekuivalente me vlerën neto të çmimit të qirasë, përveç një pagese të derdhur në tetor të vitit 2011 (me përshkrimin “shtator 2011”), e cila përkon me vlerën bruto të qirasë. Ky fakt dëshmon që shoqëria qiramarrëse e ka njohur dhe e ka zbatuar detyrimin e saj ligjor për llogaritjen dhe mbajtjen në burim të tatimit mbi vlerën bruto të qirasë, pavarësisht faktit të parashikimit jo të qartë në kontratën e qirasë mbi procedurën që duhet ndjekur për përcaktimin e masës së tatimit dhe pagesës së saj sipas kërkesave ligjore në fuqi. Ky konkluzion i trupit gjykues vjen në harmoni të plotë me parashikimet e Kodit Civil mbi

interpretimin e kontratave<sup>20</sup>. Të mosprovarit e pagesës së tatimit të mbajtur nga kjo shoqëri tregtare në llogarinë e buxhetit të shtetit, referuar korrespondencës me organin tatimor, sipas shkresës së cituar edhe në vendimin e Komisionit, në vlerësimin e trupit gjykues nuk sjell asnjë efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit me burim qiranë, për sa kohë e ardhura prej kësaj të fundit, e përfituar nga qiramarrësi, është zvogëluar me vlerën e detyrimit tatimor që përcakton ligji dhe për sa kohë pagimi i kësaj shume në buxhetin e shtetit nuk është detyrim i tij. Për më tepër që legjislacioni tatimor parashikon sanksione administrative për agjentët e mbajtjes së tatimit në rastet e llogaritjes dhe mbajtjes së tatimit, por mospagimit në llogarinë e buxhetit të shtetit<sup>21</sup>.

72. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se formulimet konkrete në nenet e këtyre dy kontratave, të cilat kanë përcaktuar detyrimet e palës qiradhënëse, jo vetëm nuk mund të interpretohen në drejtim të përcaktimit të detyrimit për kryerjen e pagesës së tatimit nga ana e qiradhënësit, por as nuk kanë shërbyer si klauzola për të shmangur palët kontraktuale nga përmbushja e detyrimeve të tyre ligjore. Këtë konkluzion e mbështet më së miri ecuria e mënyrës dhe masës së pagesës së qirasë të kryer nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK deri në prill të vitit 2013, si dhe marrëdhënia e krijuar mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK me organin tatimor, ku referuar korrespondencës së kësaj të fundit me Komisionin, rezulton se kjo shoqëri ka një detyrim tatimor të njohur dhe të deklaruar në lidhje me pagesat për qiratë, për periudhën që përfshin kontratën me subjektin e rivlerësimit, në vlerën prej 4.570.250 lekësh.
73. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi të verifikojë nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor edhe vlerën totale të përfituar në cilësinë e të ardhurës nga qiraja dhe vlerësimin nëse kjo e ardhur e përfituar nga ana e subjektit të rivlerësimit është apo jo në masën e të ardhurës bruto të qirasë, rast në të cilin do të konfirmohej keqbesimi i subjektit të rivlerësimit në mospërmbushjen nga ana e palës qiramarrëse të detyrimit për pagesën e të ardhurës nga qiradhënia.
74. Për efekt të këtij verifikimi, duke mbajtur në konsideratë: (i) mosekzekutimin e detyrimit për pagesë të çmimit të qirasë nga ana e shoqërisë {\*\*\*} ShPK në mënyrë të rregullt gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ku janë vënë re pagesa përtej masës së çmimit mujor të qirasë dhe mospagime për muaj me radhë; (ii) parregullsinë në drejtim të sa më sipër edhe nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nga muaji prill 2013 deri në mbylljen e kontratës nga palët me efekt nga data 1 gusht 2013; (iii) faktin që shoqëritë qiramarrëse përveçse janë përfaqësuar në këtë marrëdhënie kontraktuale nga i njëjti person, rezultoi nga verifikimi i kryer në bazën e të dhënave publike të QKB-së edhe se kanë pasur të njëjtin ortak me pjesëmarrje 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë gjatë periudhës objekt kontrolli; (iv) faktin që tashmë këto janë marrëdhënie kontraktuale të mbyllura dhe palët janë likuiduar me njëra tjetrën – trupi gjykues, në kuadër të vlerësimit sa më të drejtë të çështjes, vlerësoi që të përlllogaritet pagesa totale e përfituar nga këto dy shoqëri, në kuadër të kushteve të kontratës dhe të krahasohet kjo vlerë me vlerën totale neto dhe bruto që del sipas përlllogaritjeve për gjithë periudhën kontraktuale.
75. Nga ky verifikim, rezultoi se qiradhënësit (përfshirë këtu dhe subjektin e rivlerësimit) kanë përfituar në llogarinë bankare në emër të z. P. R., pranë Raiffeisen Bank, të përcaktuar në kontratë si llogaria për kryerjen e pagesave në favor të qiradhënësve, vlerën totale të pagesave prej

<sup>20</sup> Shih nenin 681 të Kodit Civil në të cilin parashikohet se kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

<sup>21</sup> Shih nenin 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

12.697.000 lekësh, ku secilit qiradhënës i takonte  $\frac{1}{4}$  pjesë e barabartë me vlerën 3.174.250 lekë. Ndërkohë, referuar parashikimit të këtyre kontratave, vlera totale bruto e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia arrin masën 14.281.000 lekë, ku secilit qiradhënës i takonte vlera prej 3.570.250 lekësh, ndërsa vlera totale neto, pas zbritjes së detyrimit tatimor, rezulton të jetë 12.852.900 lekë, respektivisht 3.213.225 lekë për secilin qiradhënës. Nga krahasimi i këtyre vlerave, konstatohet se pagesat e përfituara nga secili qiradhënës (duke prezumuar që çdo pagesë e derdhur në llogarinë e z. P. R. ka qenë e dedikuar vetëm për shlyerjen e çmimit të qirasë dhe jo për pagesa apo detyrime të tjera në kuadër të kësaj marrëdhënieje kontraktuale) kanë qenë dukshëm më të vogla se vlera neto e përlogaritur mbi bazën e çmimit (bruto) të qirasë së kontraktuar.

76. Ndërkohë, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, pranë ILDKPKI-së në deklaratimet periodike të viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014<sup>22</sup>, të cilat përputhen me të ardhurat e deklaruara prej saj në Deklaratat Individuale Vjetore të të Ardhurave për të njëjtat vite<sup>23</sup>, të konfirmuara edhe nga ana e Drejtorisë Rajonale Korçë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar në total si të ardhura nga qiraja, vlerën prej 2.831.652 lekësh.
77. Në analizë të rezultateve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përfituar të ardhura që tejkalojnë vlerën neto që i takonte të përfitonte në mënyrë të ligjshme nga kjo marrëdhënie kontraktuale. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se pavarësisht problematikave në ekzekutimin e kontratave nga ana e palëve qiradhënëse, subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura të ligjshme, të cilat do duhet të ishin përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në masën e tyre, sipas deklarimeve periodike të subjektit ndër vite.
78. Sa i takon marrëdhënies me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, zbatimi i kontratës prej kësaj të fundit nuk sjell asnjë efekt në dëm të palës qiradhënëse, pasi pagesat janë të rregullta, muaj për muaj, korrespondojnë në vlerën neto dhe totali i tyre po ashtu është i njëjtë me vlerën neto të qirasë që u takonte qiradhënësve nga marrëdhënia e lidhur me këtë shoqëri.
79. Lidhur me analizën financiare për vitin 2003, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka “neglizhuar” të marrë në konsideratë likuiditetet e krijuara deri në fillim të vitit 2003, në vlerën 1.000.000 lekë, dhe se nuk ka kryer analizë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit nga viti 1994 deri në vitin 2002.
80. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për moskryerjen e një analize financiare nga ana e Komisionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të për periudhën nga viti 1994 - vitin 2002 ishte i bazuar. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni nuk kishte kryer asnjë verifikim lidhur me mundësinë e krijimit nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të të këtij kursimi ndër vite, por në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi kishte rrëzuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit me arsyetimin se ky i fundit nuk kishte deklaruar në DIPPV-në e vitit 2003, kursimin *cash* në vlerën prej 1.000.000 lekësh, edhe pse në këtë deklaratë, referuar parashikimit ligjor të kohës, duhet të deklaroheshin vetëm pasuritë gjendje në momentin e deklaramit, që i korrespondonte datës 17.03.2004, duke qenë se ky ishte deklarim për herë të parë sipas parashikimeve të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

<sup>22</sup> Kontrata me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK ka përfunduar më datë 19.09.2014. Për efekt të përlogaritjes së vlerës që u takon pagesave të përfituara nga “{\*\*\*}” ShPK, është zbritur nga vlera e deklaruar në vitin 2014 pagesa e dy muajve qira të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>23</sup> Përfunduar viti 2011, vit në të cilin nuk kishte hyrë ende në fuqi detyrimi për deklarimin vjetor të të ardhurave.

81. Në kuptim të sa më sipër u vlerësua e nevojshme verifikimi i mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar gjendjen e likuiditeti *cash* në vlerën prej 1.000.000 lekësh deri në vitin 2002, me qëllim verifikimin e pretendimit mbi përdorimin e tij për mbulimin e shpenzimeve të kryera në vitin 2003. Nga verifikimi i kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, nëpërmjet kryerjes së një vlerësimi dhe analize financiare për vitet 1984 - 2002, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi të krijojnë me burime të ligjshme likuiditetin në gjendje *cash* në vlerën prej 1.000.000 lekësh në fund të vitit 2002, për të mund t'u përdorur për shpenzimet e kryera në vitin 2003, duke e bërë këtë vit financiar me rezultat pozitiv.
82. Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2011-2014, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e Komisionit sa i takon rezultatit financiar negativ në këto vite, me pretendimin se tabelat financiare të cilat paraqesin analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të për vitet 2011-2014, janë të pasakta dhe të plotësuara me të dhëna të manipuluar. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ngriti pretendime në lidhje me mospërllogaritjen e saktë të të ardhurave nga puna e saj, të të ardhurave të deklaruara nga qiradhënia e pikës së karburantit, si dhe me përlogaritjen e shpenzimeve të jetesës për vitet 2012, 2013 dhe 2014.
83. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues pasi vlerësoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe verifikoi të dhënat e tabelave në të cilat janë paraqitur analizat financiare nga Komisioni për periudhën objekt kontrolli sipas këtij shkak, në konsideratë edhe të konkluzioneve të arritura më sipër në vendim lidhur me çështjen e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia e pasurisë “pikë karburanti”, arriti në konkluzionet e mëposhtme.
- a) *Për vitin 2003* – Duke marrë në konsideratë totalin e të hyrave për këtë vit, në vlerën prej 3.468.804 lekësh, shpenzimet totale në vlerën prej 3.180.616 lekësh, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi të mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet e kryera gjatë këtij viti, pasi rezultuan me gjendje financiare pozitive në vlerën e 278.930 lekëve.
- b) *Për vitin 2011* – Duke marrë në konsideratë të gjithë të ardhurat nga qiraja sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2011, duke përlogaritur si burim për blerjen e garazhit<sup>24</sup> pakësimin e pasurisë likuiditet gjendje *cash*, sipas deklaramit në DIPPV-në e 2011, rezultati financiar i vitit 2011 përlogaritet pozitiv, në vlerën prej 55.368 lekësh.
- c) *Për vitin 2012* – Duke përlogaritur shpenzimet e jetesës në vlerën prej 564.096 lekësh sipas INSTAT-it dhe jo në vlerën prej 775.857 lekësh të përlogaritur nga Komisioni, duke marrë në konsideratë në zërin “të ardhurat nga paga e subjektit” edhe vlerën prej 53.500 lekësh si pagesë në kuadër të anëtarësisë në Këshillin e Prokurorisë, të cilat gabimisht nuk janë përfshirë në analizë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera në këtë vit, në vlerën prej 138.117 lekësh.
- ç) *Për vitin 2013* – Duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga qiraja sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2013, konfirmuar njëkohësisht kjo vlerë edhe sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë<sup>25</sup>, duke përlogaritur të ardhurat e krijuara në cilësinë e anëtares së Këshillit të Prokurorisë, në vlerën prej 22.500 lekësh, të cilat gabimisht nuk janë përlogaritur nga Komisioni, si dhe duke përlogaritur shpenzimet e

<sup>24</sup> Referoju analizës së shkakut të ankimit lidhur me këtë pasuri të paluajtshme në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>25</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2017.

jetesës sipas INSTAT-it, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera për vitin 2013, në vlerën prej 231.341 lekësh.

d) *Për vitin 2014 – Duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga qiraja, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2014, konfirmuar njëkohësisht kjo vlerë edhe sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë<sup>26</sup>, duke përlllogaritur të ardhurat e krijuara në cilësinë e anëtares së Këshillit të Prokurorisë, në vlerën prej 67.500 lekësh, të cilat gabimisht nuk janë përlllogaritur nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera për vitin 2014, në vlerën prej 402.539 lekësh.*

84. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në faktet e provuara gjatë procesit të rivlerësimit, shkakun e ankimit lidhur me kundërshtimin e rezultatit financiar për vitet objekt kontrolli dhe, për rrjedhojë, të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit në këtë drejtim.
85. *Lidhur me vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi”, të regjistruar si të tillë në ZVRPP-në Korçë, por të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si “garazh”, për të cilën subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për mospërputhje në deklarime lidhur me llojin e pasurisë, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
86. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij: *Për sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje në lidhje me llojin e pasurisë të konfirmuar nga ZVRPP-ja Korçë, që është “njësi” dhe deklarimin përkatës në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2011, si dhe në deklaratën “vetting”, ku kjo pasuri deklarohet nga personi i lidhur me subjektin, z. A. B., bashkëshorti i subjektit, si e llojit “garazh”. Edhe në legjislacionin për pasuritë e paluajtshme, ato janë të përcaktuara si dy lloje të ndryshme pasurish, duke pasur edhe efekt të ndryshëm financiar në sistemin tatimor. Nga analiza financiare për vitin 2011, nuk rezultojnë burime të mjaftueshme e të ligjshme financiare për blerjen e njësisë dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera në shumën prej -965.801 lekësh.*
87. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit se lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, ka mospërputhje mes të dhënave të regjistrimit të pasurisë dhe deklarimeve të subjektit sa i takon llojit të saj, me efekt në trajtimin e ndryshëm financiar të kësaj pasurie në sistemin tatimor, si konkluzion të gabuar dhe rrjedhojë e mungesës së arsyetimit dhe mosnjohjes së legjislacionit në fushën e tatimeve, konkretisht ligjit lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe atij për taksat vendore. Gjithashtu subjekti kundërshtoi si “absurd” konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë garazh, në vlerën e 1.000.000 lekëve, ndërkohë që sipas subjektit, Komisioni nuk e ka kundërshtuar vlerën e likuiditeteve në masën 5.535.782 lekë në fillim të vitit 2011.
88. Nga shqyrtimi i këtij shkakui të ankimit, referuar arsyetimit të Komisionit në vendimin e tij lidhur me deklarimin e kësaj pasurie në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi fillimisht se Komisioni nuk ka dalë në një konkluzion të qartë lidhur me këtë pasuri. Komisioni rezultoi të ketë konstatuar një mospërputhje mes të dhënave të regjistrimit të pasurisë në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe atyre të deklarimit të subjektit në deklarimin periodik dhe atë të pasurisë *vetting*, lidhur me llojin e kësaj pasurie, por nuk ka treguar

<sup>26</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2017.

nëse kjo mospërputhje sjell apo jo një pasojë juridike konkrete për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut përkatës për vlerësimin e kriterit të pasurisë të ligjit nr. 84/2016.

89. Referuar mënyrës së deklarimit të kryer në DIPPV-në e vitit 2011 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar fotove të objektit të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe korrespondencës së Komisionit me organin tatimor<sup>27</sup> në kuadër të hetimit të kryer në drejtim të mënyrës së përdorimit të kësaj pasurie të paluajtshme, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se këtë pasuri e ka deklaruar sipas funksionit për të cilin e përdor, konkretisht “garazh” për automjetin në pronësi të bashkëshortit, provohet si i vërtetë. Fakti që këtë deklarim subjekti në të dyja rastet e ka shoqëruar me deklarimin e të dhënave të kontratës noteriale të shitblerjes, në të cilën pasuria specifikohet sipas të dhënave të regjistrimit të saj në ZVRPP-në Korçë, e çon trupin gjykues në përfundimin që mospërputhja në të dhënat e deklaruara lidhur me llojin e pasurisë nuk sjell asnjë pasojë ligjore në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.
90. Ndërkohë, sa i takon konkluzionit të Komisionit që pasuria e llojit “njësi” i nënshtrohet një regjimi të ndryshëm tatimor në raport me llojin e pasurisë “garazh”, ky konkluzion edhe pse është i saktë, çmohet nga trupi gjykues pa relevancë në rastin objekt gjykimi, pasi transaksioni i shitblerjes së kësaj pasurie është kryer sipas përcaktimit të saktë të llojit të saj dhe se deklarimi nga subjekti në deklaratat e pasurisë, sipas funksionit për të cilin është përdorur kjo pasuri, nuk ka sjellë asnjë efekt në drejtim të detyrimeve tatimore, qoftë në momentin e kalimit të pasurisë, qoftë në vazhdim, në drejtim të pagesës së taksës së pasurisë së paluajtshme, e cila përcaktohet mbi bazën e të dhënave zyrtare të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme ku ajo figuron si “njësi”.
91. Sa u takon pretendimeve lidhur me ekzistencën e burimeve të mjaftueshme financiare për blerjen e garazhit në vitin 2011, në vlerën e 1.000.000 lekëve, si pasojë e përdorimit të likuiditeteve të akumuluarra deri në fillim të vitit 2011, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në DIPPV-në e vitit 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar lidhur me këtë pasuri, në rubrikën e përshkrimit të pasurisë dhe burimit të saj: “pakësuar pasuria nga blerja e një garazhi me burim të ardhurat”. Komisioni ndërkohë në tabelën e pakësimeve në kursimet *cash*, sipas deklarimeve periodike<sup>28</sup> të subjektit të rivlerësimit, ka pasqyruar si pakësim të gjendjes së likuiditetit *cash* vetëm vlerën prej 760.000 lekësh, vlerë kjo e cila sipas së njëjtës DIPPV u takon shpenzimeve të kryera për (i) studimet e fëmijëve, në vlerën e 700.000 lekëve; dhe (ii) shpenzimeve për kontributet për pension privat, në vlerën e 60.000 lekëve. Të dyja këto shpenzime janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit me përshkrimin: *pakësuar pasuria nga pagesat [...] me burim nga të ardhurat*.
92. Nga sa më sipër konstatuar, trupi gjykues e gjen të pajustificuar mospërfshirjen e pagesës së vlerës së blerjes së garazhit si pakësim të gjendjes së likuiditetit *cash*, dhe pasqyrimin e këtij transaksioni në analizën financiare të vitit 2011 me burim përdorimin e likuiditeteve gjendje në fillim të vitit 2011. Nga verifikimet e kryera nga ana e Njësisë së Shërbimit Ligjor sipas këtij konkluzioni të trupit gjykues, rezultoi që analiza financiare e këtij viti paraqitet me vlerë pozitive. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së garazhit nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nuk gjendet i bazuar në fakte. Në përfundim të analizës së mësipërme, ky shkak i ankimit gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe

<sup>27</sup> Në shkresën e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2018, në vijim të kërkesës së Komisionit ka informuar këtë të fundit se në adresën e objektit, rruga “{\*\*\*}”, Korçë, nuk ushtrohet aktivitet, objekti është garazh makine në pronësi private.

<sup>28</sup> Shih tabelën në faqen 47 të vendimit të Komisionit.

në ligj dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit në lidhje me vlerësimin e kësaj pasurie objekt kontrolli është i cenueshëm.

93. *Lidhur me transaksionin e konvertimit të likuiditeteve gjendje në lekë në 26.000 euro në vitin 2009*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka gabuar në trajtimin e transaksionit të konvertimit si mosdeklarim në DIPPV-në e vitit 2009, duke qenë se në formularin e deklarimit të vitit 2009 kërkohet deklarimi i likuiditeteve, pa u shprehur kërkesa për paraqitjen e tyre të detajuar sipas çdo monedhe të mundshme të poseduar nga subjekti deklarues.
94. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar parashikimit të nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, konstaton se subjektit i është kërkuar të deklarojë shtesat dhe pakësimet në lidhje me *vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*. Në vlerësim të kësaj dispozite ligjore, trupi gjykues çmon se qëllimi i këtij parashikimi ligjor është deklarimi i saktë i likuiditeteve nga ana e subjekteve deklaruese, në secilin lloj dhe formë që ato disponohen. Për rrjedhojë, subjekti duhet të kishte deklaruar likuiditetin e kursyer gjendje më 31.12.2009, në monedhën përkatëse. Megjithatë, edhe pse konkluzioni i Komisionit gjendet i bazuar në ligj, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë edhe konkluzionin tjetër të arritur nga Komisioni në vendim si dhe të konfirmuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor, se subjekti nuk ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e këtij likuiditeti në gjendje *cash*, arrin në përfundimin se një pasaktësi e tillë në deklarimin periodik të vitit 2009 nuk sjell asnjë efekt në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, nuk përbën shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
95. *Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për mospërputhje midis të ardhurave në deklarimet periodike të pasurisë për periudhën 2003-2010 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, me pretendimin se në deklaratat periodike janë deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke filluar nga viti i parë i deklarimit 2003, ndërkohë që në deklaratën e pasurisë janë deklaruar të ardhurat e krijuara nga gjithë aktiviteti i shoqërisë në fjalë, e cila daton që në vitin 2001. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, edhe metodologjia e përdorur nga Komisioni për përcaktimin e fitimit nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas metodës së mesatares së ponderuar, është e gabuar.*
96. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ka arritur në përfundimin se në konsideratë të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave dhe ku pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ka konsideruar si të ardhura të ligjshme vetëm ato që janë konfirmuar nga autoritetet përgjegjëse, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.
97. Në vlerësim të këtij shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në raport me vlerësimin e Komisionit, konstatoi se pretendimi i ngritur nga ana e subjektit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me mospërputhjen e deklarimeve lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është i pabazuar pasi rezulton nga arsyetimi në vendimin e Komisionit që ky ka qenë një konkluzion paraprak i cili, pas kalimit të barrës së provës dhe shqyrtimit të

kundërshtimeve të subjektit, ka rënë si konkluzion. Sa i takon çështjes së kundërshtimit të metodologjisë së përlllogaritjes së fitimit të krijuar nga ana e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në mungesë të të dhënave zyrtare mbi fitimin e krijuar, trupi gjykues vlerësoi se analizimi i këtij shkakut është i panevojshëm pasi ai nuk sjell asnjë efekt në zgjidhjen e çështjes, duke qenë se pasoja e vetme e një vlerësimi të ndryshëm të këtyre të ardhurave do të ndikonte në rezultatin financiar të vitit 2003, i cili, referuar trajtimit të bërë nga trupi gjykues më sipër në vendim, rezulton pozitiv, pa përfshirë të ardhurat nga “{\*\*\*}” ShPK, të cilat vetëm do mund ta përmirësonin rezultatin financiar të këtij viti.

98. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzionit të Komisionit mbi pasaktësitë në gjendjen e kursimeve cash të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, lidhur me këtë çështje, është shprehur: Në lidhje me mospërputhjen e konstatuar ndërmjet deklarimit nga ana e subjektit të kursimeve cash në deklaratat periodike vjetore për çdo vit deklarimi, shumës së shpenzimeve të mbuluara nga kursimet cash për çdo vit deklarimi, krahasuar me të dhënat për këta dy zëra të deklaruar nga ana e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, edhe pas shpjegimeve përfundimtare të dërguara nga subjekti, referuar paraqitjes tabelare të të dhënave si më poshtë<sup>29</sup>, Komisioni krijoi bindjen se ka pasaktësi lidhur me sa më sipër.*
99. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues së pari vlerëson se Komisioni nuk ka qenë i qartë në konkluzionin e tij lidhur me çështjen e likuiditetit në gjendje *cash*, referuar deklarimeve të subjektit ndër vite, pasi edhe pse pretendon ekzistencën e pasaktësive në deklarimin e tij, nuk ka treguar efektin që sjell ky konstatim në kontrollin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Së dyti, nga verifikimi i kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, nuk rezultoi që në vitet e marra në analizë, subjekti të ketë deklaruar pasuri të llojit likuiditet në gjendje *cash*, për të cilin të ketë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e tij. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen pa efekt në vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, konkluzionin e sipërtrajtuar të Komisionit.
100. Në përfundim të vlerësimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin e vlerësimit të Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se i vetmi konkluzion i Komisionit, i cili rezultoi i drejtë dhe i bazuar në faktet e provuara dhe në ligj, ishte se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se *personi tjetër i lidhur me të* (babai i saj) kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënie e kontributit në formën e investimit, në vlerën e 375.000 lekëve në favor të subjektit të rivlerësimit. Vlera e këtij kontributi të babait të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vlerësohet nga trupi gjykues pa ndikim domethënës në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në konsideratë edhe të standardit të kërkuar për arritjen e një niveli të besueshëm gjatë kontrollit të këtij kriteri.
101. Për rrjedhojë, nga vlerësimi dhe kontrolli i imtësishëm i kryer në Kolegj lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit objekt ankimi, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë kriter vlerësimi konsiderohet i pabazuar në faktet e provuara dhe në ligj dhe, si i tillë nuk mund të përdoret si bazë për shkarkimin e subjektit nga detyra.

---

<sup>29</sup> Shih tabelat në faqet 47 dhe 48 të vendimit të Komisionit.



102. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në analizën e mësipërme faktike dhe ligjore, çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm, bazuar në parashikimin e nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, nuk mund të konfirmohet në detyrë nga Kolegji, për arsye se Komisioni në vendimin e tij nuk ka konkluduar lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale. Në këto kushte, vendimi i Komisionit objekt ankimi duhet të priset dhe Komisioni, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, duhet të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Të prishë vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 109, datë 19.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli.
2. Të urdhërojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irma Balli, edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.06.2021, në Tiranë.

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi – kundër*

#### **RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi – kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, nuk ishim dakord me vendimin e shumicës në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 109, datë 19.02.2019, dhe votuam kundër për arsyet e shtjelluara më poshtë.
2. Shumica vendosi të prishë vendimin e Komisionit dhe të urdhërojë kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Në vlerësimin tonë, vendimi objekt ankimi i Komisionit duhet të ishte lënë në fuqi dhe masa disiplinore e shkarkimit nga detyra të ishte konfirmuar nga trupi gjykues i Kolegjit. Ky përfundim mbështetet në arsyetimin që subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për shkak të pasaktësive në deklarin e burimeve financiare, të deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë dhe të të ardhurave, të mungesës së burimeve të ligjshme për kryerjen e investimeve, si dhe të dyshimeve për ndërhyrje të pajustificuar në dokumentacion e depozituar për regjistrimin e njëjës prej pasurive. Për sa më sipër, Komisioni gjeti që subjekti gjendet në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe vendosi shkarkimin nga detyra të znj. Irma Balli.
3. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe akteve shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe atyre të administruara në fashikull nga Komisioni, vlerësuam se në tërësinë e tij, vendimi i Komisionit është mbështetur mbi një analizë të drejtë të ligjit dhe jurisprudencës së vetë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërsa problematika me deklarin e pasurisë nga ana e subjektit – identifikuar dhe arsyetuar nga Komisioni – paraqiste rrethana serioze deklarin të pamjaftueshëm dhe përpjekje të paraqitjes në mënyrë të pasaktë të pasurive në pronësi, që e bënin të nevojshme lënien në fuqi të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin. Njëkohësisht, aktet shkresore dhe shpjegimet e parashtruar nga subjekti i rivlerësimit – duke përfshirë edhe përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe ato në seancën publike në Kolegj – nuk arritën të provojnë të kundërtën e prezumimit ligjor në drejtim të masës së shkarkimit nga detyra.
4. Arsyetimi i qëndrimit tonë kundër fokusohet kryesisht në tri aspekte kryesore të kontrollit të pasurisë dhe gjetjeve të Komisionit, e konkretisht: (I) probleme lidhur me pasaktësinë e pamjaftueshmërinë e deklarin të pasurisë “karburant prej katër (4) katesh”; (II) pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për shpenzimet e kryera për apartamentin me sipërfaqe 179 m<sup>2</sup> në Korçë në vitet 2003-2004; (III) mungesën e deklarin të transaksioneve bankare në vitin 2009. Më poshtë vijon arsyetimi sipas së njëjtës radhë.
  - I. Pasuria “karburant me sipërfaqe 509 m<sup>2</sup>, prej katër katesh” në Korçë, në bashkëpronësi me ¼
    - (a) *Mospërputhjet dhe ndërhyrjet në dokumentacionin ligjor që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë*
5. Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i kanë rezultuar mospërputhje mes dokumentacionit të depozituar në Drejtorinë Rajonale të Arkivave Shtetërore në Elbasan (në vijim “Arkivat”), me atë të depozituar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) në Korçë për sa i përket numrit të kateve për të cilat është dhënë leja e ndërtimit. Konkretisht, ndërsa sipas dokumentacionit në Arkiva rezultojnë “Kërkesa për shesh ndërtimi” e datës 10.06.1997 [formulari nr. 1] për dy kate dhe planimetri kati “TIP”, në dokumentacionin e depozituar në ZVRPP, Komisioni ka konstatuar ndërhyrje në fjalën TIP, si vijon: në fotokopjet e dokumentit kjo

fjalë është ndryshuar në “I-rë”, “II-të” dhe “III-të”. Po ashtu, planimetria e katit “TIP”, e cila gjendet në Arkiv në Elbasan, nuk gjendet në ZVRPP në Korçë. Me fjalë të tjera, nga dokumentacioni rezulton që leja e ndërtimit të jetë lëshuar për *dy* (2) kate, planimetria në fashikull i përket një kati “tip”, ndërsa regjistrimi në ZVRPP është kryer për katër kate (3 kate plus papafingo). Regjistrimi në ZVRPP [tri kate plus papafingo] është kërkuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, e cila ka kryer edhe gjithë aplikimet e nevojshme në periudhën 2000-2009 dhe ka kryer pagesat e tarifave administrative përkatëse. Më konkretisht, nga aktet shkresore rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ka kryer katër (4) aplikime në periudhën 2000-2009, respektivisht në korrik 2000, shtator 2008 dhe dy aplikime në vitin 2009, përkatësisht në qershor dhe maj. Nga korrespondenca administruar në fashikull më datë 18 gusht 2010, mes Zyrës së Urbanistikës së Bashkisë Korçë dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë, rezulton se kjo e fundit ka konstatuar shtesë kati të kryer në vitet 1999-2003, për të cilën ka kërkuar informacion shtesë. Qartazi, nuk mund të ketë qenë në pyetje shtesa anësore (shtjelluar më poshtë, ndërtuar në vitin 2008, sipas subjektit të rivlerësimit), në kushtet kur shpjegimi i Urbanistikës së Bashkisë fokusohet në detajet që përfshinte koncepti *rikonstruksion* në harkun kohor 1999-2003, që nuk përkon as me lejen e ndërtimit [nëntor 1997]<sup>30</sup> që përbën dokumentin fillestar në kohë.

6. Pavarësisht se aktet shkresore dëshmojnë përfshirjen e saj në procesin e krijimit dhe më pas regjistrimit të pronës, subjekti ka pretenduar së pari se e gjithë praktika është ndjekur nga i ati dhe jo nga ajo vetë. Po ashtu, subjekti ka theksuar se sipas ligjit nr. 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” është zyra që ka dhënë lejen, ajo e cila komunikon me ZVRPP-në. Me fjalë të tjera, subjekti i rivlerësimit ka mohuar përfshirjen e saj në dinamikën e krijimit të kësaj prone, mohuar çdo përgjegjësi për problemet në dokumentacion, si dhe ka mohuar dijeninë për ekzistencën e tyre përgjatë gjithë harkut kohor mbi 20-vjeçar [1997-2019]. Dokumentacioni tregon që subjekti ka qenë përfshirë në regjistrim, ka qenë edhe formalisht bashkëpronare e truallit teksa mbi të ndërtohej pasuria, e më pas bashkinvestitore, siç shtjellohet më poshtë. Si rrjedhojë, mungesa e dijenisë për zhvillimet, problematikën me të cilën shoqërohej ndërtesa, nuk është bindëse. Argumenti i theksuar prej saj dhe i pranuar prej shumicës, që gjen përgjegjësitë për mospërputhjet e konstatuara mes dokumentacionit dhe realitetit tek institucionet – në këtë rast, Urbanistika dhe ZVRPP – apo që bazohet mbi faktin që fashikulli i ndodhur në Arkiv karakterizohet nga probleme të tjera parregullsie – ishte jobindës për ne, gjyqtaret e pakicës.
7. Këto argumente, ndër të tjera, bien ndesh me procedurën e detajuar në hollësi nga dispozitat që kanë rregulluar ndërtimet pa leje. Konkretisht, aplikimi për regjistrim sipas ligjit nr. 7843/1994 [neni 38], kryhet mbi bazën e aktit të organit administrativ – në këtë rast, zyra e Urbanistikës – dhe shoqërohet domosdoshmërisht me dokumentacion që përfshin lejen për sheshin e ndërtimit, lejen e ndërtimit, procesverbalin e kolaudimit, lejen e shfrytëzimit e dokumente të tjera. Me fjalë të tjera, aplikimet e kryera nga subjekti për legalizim, cituar më sipër, duhet të jenë shoqëruar me konfirmimin nga Urbanistika të përfundimit të ndërtimit dhe dokumentacion që përfshinte edhe lejen e ndërtimit me katet dhe planvendosjen e dokumentet e tjera që individualizojnë objektin, siç është planimetria e kateve. Ndonëse në fashikull mungon një kërkesë nga investitori [i ati i subjektit] për dërgimin e paketës së këtyre dokumenteve nga Urbanistika në ZVRPP, nga ana tjetër, rezulton aplikimi i subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e të cilit ZVRPP ka kryer regjistrimin. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, mungesat në

---

<sup>30</sup> Shkresa e Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë (nr. prot. {\*\*\*}), në përgjigje të asaj të ZVRPP-së (nr. prot {\*\*\*}), datë 17 dhe 18.08.2010 respektivisht, sipas së cilës në periudhën kohore 1999-2003 lejet për rikonstruksion përfshinin edhe shtesa kati apo anësore. Pas vitit 2003, shtesat parashikoheshin shprehimisht në lejet e ndërtimit, sipas Urbanistikës.

dokumentacion apo problemet e pretenduara prej saj në formën e parregullsisë në fashikull, nuk duket se kanë përbërë pengesë për regjistrimin e pronës në zbatim të kërkesës së saj. Përkundrazi, ndryshe nga sa përcaktojnë aktet e vitit 1997 – kërkesa për shesh ndërtimi e datës 10.06.1997 [Formulari 1] – për dy kate, ndërtesa është legalizuar dhe regjistruar për 3+1 kate në vitin 2011.

8. Në kushtet kur hetimi i arsyeve për të cilat institucionet përgjegjëse vendore kanë mundur legalizimin e një ndërtimi me dokumentacion minimalisht në kushtet e parregullsisë – apo mbi të cilin janë kryer ndërhyrje – për një pronë që i përket një magjistrateje në funksione drejtuese mbi 30 vjet dhe në të njëjtin qytet – është përtej tagrave të institucioneve të rivlerësimit, zgjedhim vetëm të sjellim në vëmendje se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë kategorike dijenie të këtyre problemeve deri në kohën kur ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit, është jobindës. Njëherazi, është e pakuptimtë edhe të pranohet që ndërhyrjet apo problemet në dokumentacion, që kanë favorizuar një individ në tejkalim të dokumentacionit që ka shoqëruar lejen e ndërtimit, të jenë kryer për shkak të gabimeve njerëzore apo në mirëbesim dhe pa qenë objekt saktësimi për një hark kohor 12-vjeçar [në periudhën kohore nga 1997 deri në regjistrimin e pronës në vitin 2009]. Bindja jonë që ndërtimi ka tejkaluar lejen e lëshuar në 1997 dhe që subjekti i rivlerësimit kishte arsye të ishte në dijeni të problematikës me regjistrimin e pronës së iniciuar prej asaj vetë, konfirmohet edhe nga korrespondenca mes Urbanistikës pranë Bashkisë Korçë dhe ZVRPP-së në gusht 2010, përpara legalizimit të ndërtesës, cituar më sipër në paragrafin 5.
9. Komisioni ka konkluduar se ka dyshime të arsyeshme për ndërhyrje në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit për regjistrimin e pasurisë, duke e kategorizuar këtë gjetje si deklaram të pamjaftueshëm për subjektin. Shumica nuk ishte dakord me këtë konstatim të Komisionit pasi nuk e vlerëson si një gjetje të natyrës së kontrollit pasuror apo me efekt në procesin e rivlerësimit. Në vlerësimin tonë, pavarësisht nga terminologjia dhe arsyetimi i kufizuar i Komisionit, si pasojë e të cilit dyshime të arsyeshme për ndërhyrje në dokumentacion nuk janë arsyetuar në drejtim të veprimeve me pasoja në kriterin e vlerësimit profesional [të integritetit të subjektit], trupi gjykues i Kolegjit duhet ta kishte analizuar këtë rrethanë faktike në funksion të thelbit të natyrës së saj dhe, në kuadër të mospërkeqësimit të situatës së subjektit, të sillte në vëmendje së pari se në rastin në fjalë dyshimet për ndërhyrje në dokumentacion janë shqetësim serioz. Ndërhyrja në dokumentacionin tekniko-ligjor apo përdorimi i dokumenteve të cilat përmbajnë ndryshime, në raste të caktuara përbëjnë falsifikim dokumentesh. Përdorimi i dokumenteve në të cilat është ndërhyrë, dënohet njësoj si ndërhyrja në dokumente dhe prezantimi i tyre si të vërteta. Në kushtet kur rrethanat faktike të konstatuara nga Komisioni tregojnë dyshime të kësaj natyre, trupi gjykues i Kolegjit do të duhej minimalisht të konfirmonte gjetjen e Komisionit dhe të ripërcaktonte nëse në këto rrethana subjekti i rivlerësimit cenonte besimin e publikut, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
10. Shumica, përkundër fakteve të qarta, siç shtjellohet më sipër, zgjedhi të fokusohet në pyetjen nëse “ndërhyrja në dokumente përbën deklaram të pamjaftueshëm”. Me fjalë të tjera, u anashkalua një konstatim serioz, në favor të një leximi skematik dhe të ngurtë të deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë. Ndërkohë, leximi harmonik i dispozitave ku zberthehen parimet mbi të cilat bazohet rivlerësimi, për sa i përket kriterit pasuror, tregon që subjekteve të rivlerësimit u kërkohet një deklaram i hollësishëm dhe shterues i pasurive dhe të ardhurave, burimeve të krijimit dhe ligjshmërisë së tyre. Për më tepër, nenet 4 dhe 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikojnë, ndër të tjera, edhe në rastet kur secili kriter vlerësohet besueshëm/kualifikues, edhe alternativën e kontrollit të sjelljeve të subjekteve përkundër besimit të publikut, një koncept domosdoshmërisht i lidhur me secilin kriter, veçmas apo bashkërisht. Ky parashikim i ligjit u lejon institucioneve të rivlerësimit diskrecion që në analizë fundore të marrin në konsideratë nëse veprime të caktuara

janë të atilla saqë cenojnë besimin e publikut te drejtësia, edhe nëse subjekti është i besueshëm në secilin kriter veçmas ose bashkërisht. Me fjalë të tjera, ndërsa në rastin konkret për shkak të vendimit të Komisionit objekt kontrolli ishte vetëm kriteri pasuror, asgjë në gjuhën e ligjit nuk e ndalon trupin gjykues të Kolegjit të analizojë nëse elemente të caktuara që shoqërohen me një aset të caktuar, krijojnë shqetësim serioz, parë në kontekstin e besimit të qytetarëve te drejtësia, për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të një subjekti rivlerësimi.

11. Në rastin konkret, jemi të mendimit që një interpretim logjik i frymës së ligjit tregon që ndërhyrja në dokumentacionin me anën e të cilit subjekti i rivlerësimi, znj. Irma Balli, ka fituar të drejtat e pronësisë mbi një pasuri, e bën atë të papërshtatshme në kriterin e pasurisë. Fakti që subjekti i rivlerësimi zgjodhi të fajësonte gjithë institucionet e përfshira në proces apo anashkaloi përgjegjësinë, megjithëse ka kërkuar regjistrimin e pasurisë në periudhën kohore nga viti 2000 deri në vitin 2009 dhe mban përgjegjësi të barabartë me bashkëpronarët për çdo investim, dëshmon që ajo ishte e vetëdijshme për fatin e të dhënave në dokumentacion, i ka pranuar efektet e tij dhe gëzuar frytet. Qëllimi i procesit të rivlerësimi është që të identifikohen subjektet që kanë pasuri më tepër sesa justifikohet me dokumentacion dhe burime të ligjshme. Për këto arsye, arritëm në përfundimin që subjekti i rivlerësimi nuk përmbush kriterin e parashikuar nga pika 1, germa “a” e nenit 58 dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit duhej të ishte lënë në fuqi.

(b) *Vlera e investimit*

12. Në deklaratën periodike për vitin 2003, që është edhe deklarata e parë, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se vlera e ndërtimit të pasurisë objekt analize [pikë karburanti], në atë vit ishte përreth 10 milionë lekë, pjesa e saj takuese ishte  $\frac{1}{4}$ , dhe ka pasur për burim *kursimet familjare dhe fitimet e realizuara nga shitja e karburantit*. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*), kjo pasuri është deklaruar në vlerën 15.960.000 lekë. Po aty, subjekti ka specifikuar me shifra konkrete një investim fillestar të kryer nga një person juridik sipas një kontrate të vitit 1998 [shoqëria “{\*\*\*}”], ndërsa vlera totale e investimit të kryer nga bashkëpronarët mungon. Nga një deduktim aritmetik i shifrave të pasqyruara, përkundër kontributit të deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimi, rezulton që investimi familjar duhet të ketë qenë 5,5 milionë lekë, përfshirë edhe pjesën e pretenduar të investuar nga subjekti prej 1 (një) milionë lekësh. Ndryshe nga deklarata për vitin 2003, në deklaratën e pasurisë (*vetting*), burimi është deklaruar të kenë qenë *kursimet* dhe nga të ardhurat e personit të lidhur nga emigracioni në Greqi. Të ardhurat nga shitja e karburantit, deklaruar në vitin 2003, nuk kanë gjetur pasqyrim në burimet e krijimit të pasurisë në deklaratën e pasurisë (*vetting*).
13. Ndërsa subjekti shprehet se të katër bashkëpronarët kanë investuar bashkërisht, ajo specifikon edhe që pjesa më e madhe e investimit – 3,5 milionë lekë – është përballuar kryesisht nga babai i saj (i cili ka riinvestuar të ardhurat nga qiraja) dhe vëllai, respektivisht me të ardhura nga emigracioni në ShBA [i gjyshit të subjektit] dhe në Greqi i të vëllait të subjektit. Kjo mënyrë shpërndarjeje kontributesh mes bashkëpronarëve, përveçse bie ndesh me deklaratën periodike të kryer nga subjekti në vitin 2003 [cituar më sipër], bie ndesh edhe me deklaratën noteriale të datës 30.06.2000 [me nr. {\*\*\*}], sipas së cilës të katër bashkëpronarët (përfshirë subjektin) kanë investuar *barazimisht* dhe kanë të drejta të barabarta, “pavarësisht se në akte si investitor figuron vetëm babai i subjektit të rivlerësimi”. Për sa më sipër, pretendimi për një kontribut të reduktuar, që nuk përkon me bashkëpronësinë në  $\frac{1}{4}$  apo 25% sipas dokumentacionit, për herë të parë është bërë në qershor 2016, në shpjegimet që subjekti ka dhënë në ILDKPKI, e më pas në deklaratën e pasurisë *vetting*, më 26 janar 2017.

14. Përpos këtyre dy momenteve kohore, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion mbi vlerën e investimit, situacionet e punimeve në kohën kur janë kryer apo gjurmë të tjera dokumentare që do të provonin pagesat e kryera dhe vlerën e tyre. Ndër vite, nuk janë deklaruar as shpenzime për investimet, megjithëse, siç shtjellohet më poshtë, është kryer edhe një shtesë. Vlera e investimit mungon edhe në procesverbalin e kolaudimit të hartuar në datën 07.09.1999. Bashkë me deklaratën e pasurisë, subjekti ka bashkëngjitur një akt ekspertimi nga i cili rezulton se rrjedh vlera e deklaruar në deklaratën e pasurisë (*vetting*), cituar më sipër në vlerën 15.960.000 lekë dhe sipërfaqja prej 504,9 m<sup>2</sup> – sipas ekspertit përlllogaritur si 420 m<sup>2</sup>. Në këtë sipërfaqe, është përlllogaritur edhe një shtesë prej 12,5 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitin 2008.
15. Në përmbledhje, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë dhe të deklarojë saktësisht shpenzimet e kryera për investim, detyrim i parashikuar shprehimisht nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, ligji nr. 84/2016 dhe Udhëzimi i Inspektoratit të Lartë të ILDKPKI-së nr. 4095/2016, si kusht për të kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Në këtë kontekst, theksojmë edhe që deklarimi i saj për herë të parë në vitin 2016, për kontribut të reduktuar nga ana e saj në pasurinë në bashkëpronësi, mbeti deklarativ, përveçse bie ndesh me dokumentacionin e hartuar më herët dhe administruar në fashikull.
16. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, është bërë bashkëpronare e ¼-tës së truallit<sup>31</sup> në qershor 1998, kohë gjatë së cilës, sipas dokumentacionit në fashikull, objekti disakatësh ishte në proces ndërtimi. Bashkëpronësinë në pjesë të *barabarta* mbi këtë objekt, bashkëpronarët e kanë deklaruar edhe zyrtarisht më 19.06.2000<sup>32</sup>. Nën dritën e këtyre fakteve, pretendimi i subjektit në procesin e rivlerësimit se në fakt investimi i saj, pavarësisht nga dokumentet e kohës, nuk përkonte me ¼ e bashkëpronësisë në mënyrë të barabartë, mbeti deklarativ dhe duket si përpjekje për të minimizuar përgjegjësinë e saj për të provuar aritmetikisht burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Së dyti, interpretimi logjik i fakteve dhe provave në fashikull, sjell një konkluzion që bie ndesh me pretendimin e subjektit për mospërfshirje në veprimet që sollën krijimin e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, shkarkimin nga përgjegjësia për paplotësinë e deklarimit të kësaj pasurie. Në këtë kontekst, sjellim në vëmendje se, ndërsa ka pretenduar pamundësinë objektive për të gjetur dokumentacionin nga shoqëria ndërtuese, është e paqartë dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, asnjëherë nuk ka shpjeguar përse *ajo* vetë nuk ka vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion të çfarëdo forme, që do të pasqyronte këto investime, qoftë edhe në mënyrë të pjesshme, sipas kërkesave ligjore, pjesë e procesit të rivlerësimit. Sipas pohimit të subjektit<sup>33</sup> të rivlerësimit, znj. Irma Balli, punimet kanë vazhduar edhe pas kolaudimit të kryer në shtator 1999, deri në vitin 2000, që përkon me kohën kur edhe me akte shkresore, ajo rezulton bashkëpronare me pjesë të *barabarta* edhe e ndërtesës, përveç truallit.
17. Pavarësisht nga sa më sipër, shumica ka pranuar deklarimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, për kontribut disproporcional në pasuri nga ana e saj dhe ka bazuar analizën financiare pjesërisht në vlerat deklarative të dhëna nga subjekti, duke anashkaluar aspektin e detyrimit që sipas ligjit kanë subjektet për të provuar shpenzimet me dokumente apo faktin që nuk është përcjellë prej saj qoftë edhe një dokument i pjesshëm për të dokumentuar investimin. Votuar kundër këtij qëndrimi të shumicës pasi është i pabazuar në ligj dhe në prova. Në kundërshtim me detyrimet e saj në procesin e rivlerësimit apo si subjekt deklarues ndër vite sipas ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ka dështuar të prodhojë dokumentacion qoftë

<sup>31</sup> Me kontratën noteriale të dhurimit me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 05.06.1998, përpara noteres Zh. M..

<sup>32</sup> Me deklaratën noteriale të datës 19.06.2000, me nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., përpara së njëjtës notere si më sipër.

<sup>33</sup> Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti është shprehur se ndërtimi dhe pagesat kanë vazhduar edhe pas datës se kolaudimit (shtator 1999), deri në vitin 2000. Përgjigjet e pyetjes 1.1.

edhe të pjesshëm për shpenzimet, ndërsa deklaratimet e saj për vlerën kanë qenë të ndryshme dhe evazive në kohë të ndryshme. Qëndrimi ynë është në përputhje edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit për sa u përket detyrimeve të subjekteve të rivlerësimit në këtë proces, në drejtim dhe funksion të deklaratimit të investimeve në ndërtime të kryera nga/bashkërisht me familjarë, duke theksuar përkatësisht përgjegjësinë e subjekteve për të shpjeguar burimet e ligjshme të krijimit të pasurive apo vlerën e saktë të investimeve të kryera, qoftë edhe në kushtet e bashkinvestimit, riprodhuar respektivisht më poshtë:

“[...] trupi gjykues vlerëson se subjekti ka qenë posedues i kësaj pasurie dhe vazhdon ta ketë në pronësi edhe aktualisht, çka do të thotë se ai ka pasur detyrimin ligjor të justifikojë pasurinë me burime financiare të ligjshme. Fakti që ai është dekretuar prokuror në vitin 2002, ndërkohë që objekti është ndërtuar në vitin 2001 nuk e përjashton atë nga detyrimi si më sipër [...]”<sup>34</sup>.

“[45]<sup>35</sup>. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për përlllogaritjen e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të shfrytëzimit të objektit, Kolegji vëren se ka mospërputhje midis asaj çka ka deklaruar subjekti i rivlerësimit A. D., si pasuri, por edhe midis vlerave që rezultojnë nga deklaratat *vetting* dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes para Komisionit dhe Kolegjit, ndërkohë që nuk rezulton asnjë vlerë e deklaruar për shpenzime të tjera, sikurse, mobilim [...]”.

47. Për sa më sipër, me të drejtë, Komisioneri ka pretenduar se për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte vlerën e totalit të investimit, ashtu dhe vlerën e investimit për pjesën takuese të tij në këtë ndërtesë, për sa i përket sipërfaqes totale apo numrit të kateve që ai posedon në këtë ndërtesë [...]”.

18. Së fundmi, edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, për mungesë dokumentacioni dhe deklarime kontradiktore për shkak, ndër të tjera, edhe të mospërfshirjes në veprimet e kryera për pagesat dhe ndërtimin, nuk është bindës pasi bie ndesh me dokumentacionin e nënshkruar edhe nga ajo vetë, si dhe me rrjedhën kronologjike të veprimeve me anën e të cilave ajo ka fituar pronësinë në ¼ e objektit dhe truallit mbi të cilin ai është ndërtuar.
19. Deklarimi i plotë dhe i saktë i investimeve të kryera në këtë pasuri nga ana e subjektit do të mundësonte analizën për mjaftueshmëri të krijimit me burime të ligjshme në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në kushtet konkrete, për të gjitha arsyet më sipër, kjo analizë ishte e pamundur të kryhej. Siç përmendet në paragrafin 17 më sipër, përveç kostos së përlllogaritur më ulët për shkak të përlllogaritjes së reduktuar të papafingos në më pak se ½ e asaj reale, e për pasojë edhe të vlerës në vitin 2016, subjekti ka deklaruar vlerën 10 milionë lekë në vitin 2003, asnjë vlerë specifike në deklaratën *vetting* dhe, ndonëse janë kryer shtesa dhe investime, në mënyrë të qëndrueshme ka parashtruar versione të ndryshme në kohë të ndryshme për sa i përket përfundimit të ndërtesës apo punimeve të kryera dhe asnjë vlerë mirëmbajtjeje apo mobilimi. Me fjalë të tjera, trupi gjykues u përball me të paktën pesë vlera të ndryshme të investimit: vlerën e [përlllogaritur gabim], parashtruar nga subjekti sipas ekspertit të marrë prej saj, sipas kostove të vitit 2016, kundërvlerën e saktë nëse sipërfaqja do të përlllogaritej saktë, vlerën e dhënë nga subjekti në vitin 2003, vlerën e deduktueshme sipas deklaratës së pasurisë (*vetting*) në janar 2017, si dhe një vlerë deklarative të

<sup>34</sup> Paragrafi 55 i vendimit të Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit A. N. [JR nr. 8/2019]: [http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendimi\\_08\\_16.04.2019\\_SR\\_-A.\\_N..pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendimi_08_16.04.2019_SR_-A._N..pdf).

<sup>35</sup> Paragrafët 45 dhe 47, vendimi i Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit A. D. [JR nr. 4/2020]: [http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A\\_D.-i-anonimizuar.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A_D.-i-anonimizuar.pdf).

shtesës të parashtruar gjatë procesit të hetimit administrativ. Këto deklaramë vlerash të ndryshme nuk mund të argumentohen si deklarim i saktë, i plotë dhe as në përputhje me ligjin.

20. Përpos sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, ka qenë evazive edhe për sa i përket deklaramit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie: në vitin 2003 ka deklaruar si burim *kursimet* dhe të *ardhurat nga shitja e karburantit* e investim në vlera të barabarta mes katër bashkëpronarëve, ndërsa në deklaratën *vetting*, për herë të parë subjekti ka pretenduar investim në pjesën takuese dhe burim *kursimet* dhe të *ardhurat nga emigracioni*. Pjesa tjetër, investuar në raport disproporcional me pjesët takuese, është përballuar nga babai e vëllai i saj, me të ardhurat nga *emigracioni* – nga gjyshi dhe vëllai. Më tej, subjekti deklaron se kanë vazhduar ndërtimet/investimi nga babai i saj, me burim fitimet apo të ardhurat nga qiratë.
21. Në përmbledhje të sa më sipër, subjekti në periudha të ndryshme kohore deklaron burime të ndryshme të ardhurash nga pasuri të ndryshme, apo u referohet ndërtimeve të mëtejshme të paspecifikuara në kohë, në sasi e vlerë. Në këto kushte, përlllogaritja e mjaftueshmërisë së burimeve përbën një eksperiment tejet teorik, të pabazuar në kërkesat e Kushtetutës dhe ligjit për procesin e rivlerësimit dhe, si rrjedhojë, subjekti ka dështuar të zbatojë përgjegjësitë e saj në funksion të barrës së provës në kuadër të procesit të rivlerësimit, përcaktuar nga neni Ç, pika 5 dhe neni D, pika 5 e Kushtetutës<sup>36</sup>, si dhe neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>37</sup>.
22. Ndonëse me rëndësi, analiza e mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur, përkatësisht babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, për të kontribuar, siç pretendon subjekti për llogari dhe përfitim në favor të saj, ishte e pamundur, për sa kohë investimet e kryera kanë mbetur deklarative, kurse pjesët takuese të detyrimeve të errëta. Në këtë kontekst, theksojmë vetëm që aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit për të provuar kontributin e tyre përtej ¼ së pjesës takuese, nuk provuan mundësinë financiare me burime të ligjshme. E njëjta gjetje vlen edhe për të ardhurat e pretenduara nga emigracioni nga personi i lidhur [bashkëshorti] i subjektit të rivlerësimit. Në përmbledhje të sa më sipër, ndonëse ishim dakord në parim me shumicën për faktin që subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e krijimit të burimeve të ligjshme nga personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur, jemi të mendimit që kjo gjetje është me peshë detyësore kundrejt faktit parësor – subjekti nuk deklaroi në mënyrë të saktë dhe të plotë vlerën e investimeve të kryera në pasuri, nuk depozitoi asnjë dokumentacion që të provonte qoftë edhe pjesërisht investimin, dhe me mospërputhjet në përshkrimin e burimeve që kanë shërbyer për të krijuar pasurinë “karburant”, dështoi të deklaronte plotësisht dhe saktësisht vlerën e pasurisë dhe burimet të cilat kanë shërbyer për krijimin e saj. Edhe në versionin e parashtruar prej subjektit në funksion dhe në pritje të procesit të rivlerësimit, ekzistenca dhe ligjshmëria e burimeve të krijimit të shumës së pretenduar të investuar, në vlerën 3.500.000 lekë, nga vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit, mbetën në nivel tërësisht deklarativ, ashtu siç mbetën në nivel tërësisht deklarativ *ekzistenca* dhe *ligjshmëria* e burimeve të krijimit të shumës nga emigracioni nga personi i lidhur.

---

<sup>36</sup> Neni Ç, pika 5 parashikon që: “[...] Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”. Neni D, pika 5, fjalia e dytë parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të [...] paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi [...], zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

<sup>37</sup> “[...] Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën [...]”.



(c) *Sipërfaqja e pasurisë dhe e shtesës*

23. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*), subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë në  $\frac{1}{4}$  e truallit  $170 \text{ m}^2$  dhe të një sipërfaqeje ndërtimi prej  $120 \text{ m}^2$ . Në deklaratën e vitit 2003 sipërfaqja mungon për këtë pasuri, megjithëse është deklaruar për pasurinë tjetër [apartament  $170 \text{ m}^2$ , formulari A-1, faqja 4]. Nga shkresat e administruara në fashikull, përfshirë edhe aktin e ekspertimit të përcjellë nga vetë subjekti i rivlerësimit, sipërfaqja në total e kësaj pasurie rezulton disa herë më e madhe –  $420 \text{ m}^2$  sipas ekspertizës dhe  $504,9 \text{ m}^2$  sipas përlllogaritjes së kryer nga Komisioni, duke korrigjuar katin e katërt mbi bazën e një përlllogaritjeje të thjeshtë aritmetike të të dhënave në planimetri. Në kushtet kur subjekti ka deklaruar vetëm  $120 \text{ m}^2$  nga  $504,9 \text{ m}^2$ , ky element i deklarimit të pasurisë nga ana e saj duhet të ishte marrë parasysh nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit. Komisioni rezulton të jetë përqendruar kryesisht te shtesa në lartësi dhe mungesa e deklarimit të  $12,5 \text{ m}^2$  të shtesës – ndërkohë që rezulton se në deklaratën e pasurisë subjekti nuk ka specifikuar se pasuria në fjalë përbëhet nga katër (4) kate nga  $120 \text{ m}^2$  secili minimalisht. Për pasojë, deklarimi i subjektit për këtë aspekt të pasurisë, duhet të ishte analizuar minimalisht në harmoni me pasaktësitë dhe plotësitë e munguara prej saj në tërësi e, së bashku me sa është shtjelluar më sipër në arsyetimin tonë, të përbënte bazë për lënien në fuqi të masës disiplinore të shkarkimit. Shumica e trupit gjykues anashkaloi në mënyrë të pashpjegueshme deklarimin e mangët të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar vetëm në faktin që në fashikull ndodhej edhe certifikata e pasurisë.
24. Ky qëndrim i shumicës<sup>38</sup> është i pabazuar. Formulari<sup>39</sup> i deklarimit të pasurisë (*vetting*) urdhëron deklaruesit të përshkruajnë *hollësisht* “[...] llojin, sipërfaqen [...] vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë [...]”. Gjuha e sipërcituar e formularit qartazi kërkon deklarim të sipërfaqes, pjesës takuese etj., të pasurisë. Qëndrimi i shumicës do të ishte i drejtë nëse, në vend të sa më sipër, ligji do të kishte kërkuar vetëm certifikatën e pronësisë nga subjektet, pa specifikuar sipërfaqe, e gjithë detajet e tjera. Duke pranuar që certifikata zëvendëson gjithë sa përshkruhet në mënyrë urdhëruese në formular, shumica duket se ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar një udhëzim shumë specifik dhe shterues, për një subjekt rivlerësimi që ka zgjedhur një formë deklarimi që, së bashku me problemet e tjera në deklarim, duhet të kishin peshuar në drejtim të deklarimit të pamjaftueshëm.
25. Në vijim dhe në harmoni me sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit duhet të kishte analizuar edhe aspektet që lidhen me shtesën anësore të ndërtuar mbi këtë pasuri në vitin 2008<sup>40</sup>. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë shtesë në vitin 2008, kur ka qenë viti i ndërtimit sipas deklarimit për legalizim. Në deklaratën periodike të vitit 2015, është deklaruar shtesa në sipërfaqe  $24,9 \text{ m}^2$ , pa specifikuar vlerën e investuar. Nga dokumentacioni, Komisionit i ka rezultuar se ndryshe nga sa është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015 dhe sa rezulton nga aktet shkresore, sipërfaqja e legalizuar ka qenë  $12,5 \text{ m}^2$ , kundrejt  $24,9 \text{ m}^2$ . Përpos këtyre mospërputhjeve, siç shtjellohet në detaj më sipër, në deklaratën e pasurisë (*vetting*), subjekti ka deklaruar bashkëpronësi të saj për vetëm  $120 \text{ m}^2$  përkundër, sa është në fakt –  $504,9 \text{ m}^2$ .
26. Në përmbledhje, jo vetëm që subjekti nuk ka deklaruar shtesën e kryer në deklaratën periodike të vitit 2008, në funksion të përlllogaritjes së shpenzimeve në vitin/vitet përkatëse, detyrim që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003, por nuk ka deklaruar vlerën e investimit në shtesë as në deklaratën e

<sup>38</sup> *Shih ndër të tjerë, paragrafin 38 të arsyetimit të shumicës.*

<sup>39</sup> *Shih faqen 5 të formularit, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180/2016.*

<sup>40</sup> *Legalizuar më 22 dhjetor 2015, me sipërfaqe  $12,5 \text{ m}^2$ .*

pasurisë. Siç theksohet më sipër në paragrafin 23, askund në deklaratën *vetting* nuk referohet numri i kateve apo fakti që papafingoja ka sipërfaqe shtesë, e cila mund të argumentohet teorikisht si deklaram indirekt i sipërfaqes reale të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të evitojë gjithë këto problematika duke sjellë aktin e ekspertimit për vlerën e kohës – vitin 2016 – me gabime në përlllogaritjen e vlerës/sipërfaqe të papafingos minimalisht për 60 m<sup>2</sup> – ndërkohë që nga dokumentacioni në fashikull rezulton që papafingoja të jetë 144,9 m<sup>2</sup> – mbi dyfish më e madhe. Të gjitha këto elemente ndikojnë dukshëm në vlerën e pasurisë në total<sup>41</sup>, dhe e konfirmojnë më tej konkluzionin që kemi shtjelluar më sipër në paragrafët 12-22, për sa i përket deklaramit të pamjaftueshëm për vlerën e investimit si pasojë në procesin e rivlerësimit për subjektin. Në këto kushte, ishim kundër konkluzionit të shumicës edhe për këtë aspekt.

27. Ndryshimet që ka pësuar Kodi Penal në vitin 2008, të cilat cilësojnë ndërtimin pa leje si vepër penale, kanë ndodhur në fund të vitit<sup>42</sup>. Sipas hetimit të kryer nga Komisioni, ndërtimi në fjalë nuk ka qenë vepër penale në kohën e ndërtimit. Komisioni nuk e ka analizuar këtë aspekt minimalisht në dritën e përshtypjes që i jep publikut një ndërtim pa leje nga një magjistrate në funksione drejtuese në qytetin ku ajo drejton Prokurorinë e Apelit që nga viti 1999. Në këto kushte, në dritën e parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit në ankim, ky aspekt duhet të ishte trajtuar edhe nga shumica si element përbërës i një qasjeje të vazhdueshme evazive të subjektit në procesin e rivlerësimit, minimalisht në funksion të anashkalimit të problemeve të mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.
28. Për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar mospërputhje të dokumentacionit që lidhet me lejen e ndërtimit në dy institucione, pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë nga personi i lidhur, pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme të krijimit të shumës prej 3.500.000 lekësh nga personat e tjerë të lidhur, deklaram të pasaktë për sipërfaqen reale dhe deklaram të pamjaftueshëm për shtesën. Në konkluzionet përfundimtare, Komisioni ka shtuar edhe dyshime të arsyeshme për ndërhyrje të paligjshme në dokumentacionin e depozituar në ZVRPP Korçë. Konkluzioni i Komisionit paraqet mangësi në cilësimin e saktë të gjetjeve, në analizën e fakteve kundrejt çfarë ato përfaqësojnë, me fokus sidomos në vlerën e padeklaruar të investimeve, sipërfaqen reale të pasurisë apo ndërhyrjen në dokumentacion. Pavarësisht nga këto mangësi në arsyetimin e Komisionit, nga analiza tërësore, edhe në vlerësimin tonë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë për këtë pasuri, si dhe për aspektet e analizuara më poshtë.

*(ç) Probleme me ligjshmërinë e burimeve të krijuara nga qiradhënia*

29. Komisioni ka konstatuar probleme me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e pikës së karburantit për periudhën mars 2011-2016. Këto probleme kanë ndikuar në analizën financiare të kryer në Komision për subjektin e rivlerësimit, parë kundrejt shpenzimeve e kursimeve të deklaruara<sup>43</sup>. Shumica vendosi të pranojë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, t'u konsiderojë të ardhurat nga qiradhënia e kësaj pasurie tre personave juridikë të ndryshëm, si të krijuara me burime të ligjshme. Votua kundër shumicës, për të lënë në fuqi

<sup>41</sup> Nëse vlerat e përdorura për m<sup>2</sup> nga eksperti do të bazoheshin në përlllogaritje të saktë të sipërfaqes, ndërtesa vlerësohet 19.186.200 lekë, përkundër 15.960.000 lekë sipas ekspertit. Këto vlera nuk përfshijnë mobilimin.

<sup>42</sup> Ndryshimet e Kodit Penal nëpërmjet ligjit nr. 10023/2008. Neni 199/a parashikon: "Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet."

<sup>43</sup> Komisioni ka gjetur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitet 2011-2014.

konkluzionin e Komisionit, kryesisht duke pasur në konsideratë që në dy nga tre kontratat e qirasë, konkretisht ato të lidhura me “{\*\*\*}” ShPK dhe ajo me “{\*\*\*}” ShPK, palët kontraktore kanë rënë dakord që detyrimet e tatimeve do t’i marrë përsipër qiradhënësi<sup>44</sup>. Në kontratën e tretë, atë me “{\*\*\*}”, këtë detyrim e ka marrë përsipër qiramarrësi në mënyrë specifike<sup>45</sup>. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka gjetur që tatimet mbi qiratë mujore nga dy kontratat përkatëse, në të cilat detyrimin e ka marrë përsipër qiradhënësi [subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë], nuk janë paguar as sipas përcaktimeve kontraktore dhe as sipas ligjit.

30. Në dritën e sa më sipër, nuk ishim dakord me qëndrimin e shumicës, e cila pranoi të ardhurat nga qiratë me shoqëritë “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShPK, si të krijuara më burime të ligjshme, bazuar në prezumimin ligjor për mbajtjen e tatimit në burim<sup>46</sup>, megjithëse palët në dy kontratat përkatëse kanë rënë dakord ndryshe, në zbatim të tagrave dhe të drejtave të tyre të lirisë kontraktore sipas nenit 660 të Kodit Civil. Në rastin konkret, nuk ka asnjë element në kontratën e qirasë së lidhur mes individëve [pjesë e të cilëve ishte subjekti i rivlerësimit] dhe dy personave juridikë qiramarrës, i cili do të mund të argumentohet si rrethanë e atillë që do të ishte përtej kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi apo për të shmangur zbatimin e një norme, që do ta bënte shkakun ligjor të pavlefshëm<sup>47</sup>. Pikërisht në zbatim të respektimit të parimit të lirisë kontraktore, në një çështje të mëparshme, trupi gjykues i Kolegjit ka kushtëzuar analizën e ligjshmërisë së burimeve në dritën e përcaktimeve kontraktore të palëve për mënyrën e pagimit të tatimit mbi qiranë nga qiradhënësit. Në atë rast, Kolegji ka konkluduar që mosprovimi i ligjshmërisë së burimeve për atë subjekt rivlerësimi, ishte pasojë e mungesës së dokumentacionit apo akteve të tjera që provonin marrëdhënien e pronësisë apo veprimin e qiradhënësve për llogari edhe të subjektit të rivlerësimit<sup>48</sup>, pa vënë në dyshim kushtet kontraktore të shprehura nga palët. Për pasojë, trupi gjykues e vlerësoi ligjshmërinë e burimeve mbi bazën e provave, përcaktimeve në kontratë dhe ligjit, dhe jo mbi bazën e shpërfilljes së dakordësisë së palëve për mënyrën e pagesës së tatimeve mbi qiranë, meqenëse qiramarrësi [një person juridik] prezumohej të kishte kryer pagesat, duke çliruar nga përgjegjësia parimisht subjektin dhe bashkëpronarët.
31. Për sa më sipër, në konsideratë të vlerës ligjore që ka kontrata e lidhur mes palëve dhe dështimit të të provuarit të së kundërtës nga sa kanë rënë dakord palët në mënyrë të shprehur mes tyre për pagesat e detyrimeve tatimore në dy nga tre kontratat e qirasë për këtë pasuri, vlerësuam se konkluzioni i Komisionit duhet të ishte pranuar dhe pasqyruar të ardhurat me burime të ligjshme përkatësisht sipas viteve, ndikuar nga ndryshimet në të ardhurat që kanë shërbyer për shpenzimet dhe investimet e subjektit të rivlerësimit.

<sup>44</sup> Të dyja kontratat noteriale të qirasë, respektivisht ajo me nr. {\*\*\*} rep. {\*\*\*} kol. e datës 17.03.2011 pranë noterit A. R. dhe ajo me nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., e datës 15.11.2013, pranë noteres M. D., respektivisht në nenet 7, paragrafi IV, përcaktojnë pagimin e detyrimeve tatimore si detyrim të qiradhënësit.

<sup>45</sup> Kontrata noteriale e qirasë, datë 20.10.2014, lidhur pranë noteres D. Ç., me nr. {\*\*\*} rep. {\*\*\*} kol., në nenin 4 përcakton që qiramarrësi do të zbrisë nga qiraja mujore që i detyrohet qiradhënësit pagesën e tatimit në burim.

<sup>46</sup> Ligji nr. 8438/1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, neni 8, pika 1, germa “d”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006, i ministrit të Financave, paragrafi 2.6.3.

<sup>47</sup> Sipas përcaktimeve të neni 677 të Kodit Civil.

<sup>48</sup> Shih arsyetimin e trupit gjykues të Kolegjit në paragrafët 55.1, 55.2 dhe 56, në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z.: [JR nr. 19/2019] në [http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Z-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralet.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Z-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralet.pdf).

II. Pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për shpenzimet e kryera për apartamentin me sipërfaqe 179 m<sup>2</sup> në Korçë, në vitet 2003-2004

32. Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh për të kryer shpenzimet në vitin 2003, përfshirë dhe fokusuar kryesisht në shpenzimet që lidhen me mobilimin dhe punimet e kryera në apartamentin prej 179 m<sup>2</sup> në Korçë. Subjekti i rivlerësimit e ka trajtuar këtë shkak ankimi si pjesë përbërëse të kundërshtimeve të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003<sup>49</sup> dhe 2011-2014, ndërsa në arsyetimin e shumicës është kanalizuar në përlllogaritjen burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë së parë [pikë furnizimi me karburant] dhe ndërtesë, megjithëse kjo e fundit është kolauduar në vitin 1999 e në periudhën e ndërmjetme kohore, subjekti kishte krijuar edhe pasurinë tjetër të paluajtshme – apartament banimi me sipërfaqe 179 m<sup>2</sup> në Korçë. Në kushtet kur ky element i kontrollit pasuror i përket një shkaku të veçantë ankimi, ashtu si edhe një pjese autonome të vendimit objekt shqyrtimi<sup>50</sup>, edhe arsyetimi ynë shtjellohet veçmas.
33. Subjekti e ka deklaruar këtë apartament në deklaratën e parë për vitin 2003 si të blerë në bazë të një kontrate të korrikut 2002. Komisioni ka konstatuar<sup>51</sup> se gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti ka ndryshuar periudhën kohore gjatë së cilës janë kryer shpenzimet për arredim, e konkretisht duke e përcaktuar së pari të kryer në vitin 2002, në vlerën 1.500.000 lekë, për ta ndryshuar më pas në një pyetësor tjetër për periudhën 2003-2004 dhe pretenduar një lapsus teknik. Komisioni e ka pranuar edhe këtë version të ri, pa arsyetuar përse – megjithëse apartamenti rezulton të ketë qenë në posedim të subjektit dhe personit të lidhur që në vitin 2002, me kontratën jonoteriale për shitje. Në këtë analizë, Komisioni ka përlllogaritur në mënyrë të barabartë për vitet 2003 dhe 2004 edhe shpenzimet për punime shtesë, të deklaruara nga subjekti në vlerën 1.400.000 lekë. Edhe për këto shpenzime, gjatë fazave të ndryshme të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të zhvendosen në kohë të ndryshme në analizën financiare, përkatësisht në 2003-2004 fillimisht, dhe pas marrjes prej saj të rezultateve të hetimit, ka kërkuar të vendosen në vitin 2004. Komisioni ka zgjedhur versionin fillestar të përgjigjeve duke i ndarë shpenzimet në mënyrë të barabartë për vitet 2003-2004. Gjithsesi, nga analiza financiare e kryer për vitin 2003, duke transferuar shpenzimet në këtë periudhë kohore, subjekti ka rezultuar me diferencë të ndjeshme negative për ta mbuluar me burime të ligjshme.
34. Në kushtet konkrete, ishim të mendimit që konkluzioni i Komisionit duhet të pranohej, si për sa i përket mënyrës së shpërndarjes së shpenzimeve, në mungesë të dokumentacionit që do të provonte një periudhë të ndryshme kohore, por edhe për sa u përket të ardhurave të marra në konsideratë. Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, konstatojmë se me të drejtë Komisioni nuk ka pranuar si bindës pretendimin e subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ për kursime të mbartura nga viti 2002 në vitin 2003, të cilat nuk duket të jenë pasqyruar në asnjë formë në deklaratën periodike për vitin 2003. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se pretendimi i subjektit se ky deklaram ka munguar në kohën kur është kryer, pasi këto fonde ishin shpenzuar deri më 31 dhjetor 2002, dhe sjellim në vëmendje që Formulari A-5, i cili u dedikohet likuiditeteve, ashtu si

<sup>49</sup> Faqet 44-46 të ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

<sup>50</sup> Trajtuar në faqet 34-37, seksioni 1.2. i vendimit objekt shqyrtimi.

<sup>51</sup> Faqja 34 e vendimit më sipër.

çdo formular përbërës i deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklaram, përcakton në mënyrë të shprehur, në krye të faqes “Periudha e deklaramit” dhe në rreshtin më poshtë, harkun kohor “nga” dhe “deri”. Në çdo faqe të këtij formulari, subjekti rezulton që ka kuptuar dhe deklaruar saktësisht *gjithë* harkun kohor të vitit 2003, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2003. Kjo qasje ka ndodhur në të dyja anët përbërëse të formularit A-1, duke vijuar deri në A-8, ku subjekti i rivlerësimi, znj. Irma Balli, ka specifikuar dinamikën e veprimeve gjatë vitit 2003 për pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme [automjet], aksionet/letrat me vlerë dhe pjesët në kapitale, të ardhurat personale të saj dhe të bashkëshortit dhe detyrimet financiare [të kredisë]. Të vetmet fletë ku mungon deklarimi janë Formulari A-3 për sendet me vlerë mbi 5000 USD dhe likuiditeteve – Formulari A-5.

35. Pranimi i pretendimit deklarativ të subjektit për ekzistencë fondesh në vitin 2003, të cilat për herë të parë deklarohen *pas* rezultateve me bilanc negativ të hetimit administrativ nga ana e shumicës, bie ndesh me konceptin e deklaramit të pasurive dhe me praktikën e mirëkonsoliduar nga Kolegji për t’u bazuar në akte dhe prova – siç janë deklaramat periodike vjetore<sup>52</sup>. Evokimi i fondeve të padeklaruara, të paprovuara dhe të papretenduara më parë bie ndesh me konceptin e deklaramit dhe kontrollit të pasurive në mënyrë periodike nga subjektet apo në funksion të procesit të rivlerësimi. Fakti që deklarimi i këtyre fondeve pranohet për deklaramtën e vitit 2003, nën interpretimin se subjekti nuk mund të deklaronte një sasi të ardhurash të shpenzuar deri më 31 dhjetor 2003, është i pabazuar në ligj dhe, siç ilustron më sipër qartë, është një qëndrim në kontradiktë të hapur me formularin vetë dhe me deklaramet që ka kryer ky subjekt në kuptim të saktë të formularit – duke specifikuar gjithë dinamikën e lëvizjeve financiare në lidhje me të ardhurat e tjera gjatë vitit.
36. Edhe rrethanat në të cilat u pretendua nga subjekti ekzistenca e kësaj sasive parash në *cash*, jashtë sistemit bankar, duhet të kishin qenë mjaftueshëm bindëse për shumicën për të vlerësuar se ishim përpara pretendimeve që kryhen nën funksion të përmirësimi të situatës financiare negative pas rezultateve të hetimit administrativ, pasi më herët kishin ndryshuar përcaktimet e kohës kur ishin kryer arredimi dhe punimet e brendshme. Në vlerësimin tonë, këto ndryshime pretendimesh përbënë një përpjekje shtesë për të pranuar pretendime tejet deklarative, një seri të të cilave për këtë pasuri, Komisioni i ka pranuar pa *asnjë* provë shkresore. Ndër to veçojmë pranimin nga Komisioni të pretendimit të gabimit të citimit të datës së dhurimit të likuiditeteve nga nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimi, pranimin e pretendimit të zhvendosjes në kohë të shpenzimeve për punimet nga viti 2002 në 2003-2004 – ndërkohë që rezulton një kontratë shitjeje [jonoteriale] për apartamentin në vitin 2002, në vlerën 6 milionë lekë, deklaruar me referencë në të njëjtën datë edhe nga subjekti i rivlerësimi në deklaramtën e parë, atë të vitit 2003.

---

<sup>52</sup> *Shih paragrafët 19.4., 20.3., 20.4.dhe 21.1 të vendimit të arsyetuar të Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimi D. P. [JR 23/2019]; [http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi\\_D.-P.\\_i\\_anonimizuar\\_per\\_web.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_D.-P._i_anonimizuar_per_web.pdf), si dhe paragrafët 84 e 85 të vendimit të Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimi Xh. Z. [JR 19/2018]; [http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Z.-i-anonimizuar-perfshiremendimin-parallel.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Z.-i-anonimizuar-perfshiremendimin-parallel.pdf), ndër të tjera.*

37. Për sa më sipër, pavarësisht nga praktika jokonseguente e ndjekur nga Komisioni në vlerësimin e kriterit pasuror të subjektit të rivlerësimit edhe për këtë aspekt, që përfshin pranime deklarimesh që bien ndesh me dokumentet shkresore, nën dritën e mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit, mangësitë në deklarimin e kryer nga subjekti dhe përgjigjet e përshtatura me nevojat e momentit gjatë hetimit administrativ, duhet të ishin analizuar ndryshe nga shumica. Së bashku me analizën e shtjelluar më sipër mbi kuptimin dhe deklarimin saktë të gjithë elementeve të tjera të pasurisë nga subjekti, përveç likuiditeteve jashtë sistemit bankar, në deklaratën e parë të pasurisë [për vitin 2003] dhe rëndësisë që ka interpretimi i konceptit të deklarimit të pasurisë në frymën e tij dhe jo në mënyrë skematike, dhe të rëndësisë që i ka kushtuar Kolegji deklarimit të të ardhurave jashtë sistemit bankar në deklaratat periodike, shumica duhet të kishte konstatuar mungesë burimesh të ligjshme për vitin në fjalë. Ky element, parë në harmoni me gjithë sa është shtjelluar më sipër, kontribuon drejt nivelit jo të besueshëm në kriterin e kontrollit pasuror dhe mbështet prezumimin për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

### III. Mungesë deklarimi e transaksioneve bankare në vitin 2009

38. Komisioni është ndalur në arsyetimin e tij edhe në një shkëmbim valutë në vlerën 26.000 euro, [ekuivalenti i 3.380.000 lekëve], nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më 15.04.2009, raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) në maj 2017 ILKDPKI-së. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm mbylljen e llogarisë bankare, që përbënte vetëm një pjesë të këtij transaksioni në deklaratën periodike vjetore – në vlerën e përrreth 1.600.000 lekëve – ndërsa konvertimi dhe prejardhja e fondeve të tjera nuk është deklaruar. Gjatë hetimit administrativ, pyetur nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se këto para i janë shtuar gjendjes *cash* në shtëpi dhe, për pjesën e mbetur të shumës, prej 26.000 eurosh, ka përdorur *cash* në vlerën 945.108 lekë, gjendje nga 31.12.2008. Në kushtet kur vetë subjekti ka specifikuar, gjatë hetimit, prejardhjen e shumës që është përdorur për konvertimin, e gjejmë të pabazë qëndrimin e shumicës që anashkalon pretendimin e kryer nga subjekti në hetim dhe në ankim dhe, bazuar në përlllogaritje tejet teorike të mundësive të krijimit të burimeve – përkundër një pretendimi me shkrim të vetë subjektit për sa ishin fondet shtesë dhe nga kanë ardhur ato – për të arritur në konkluzionin që pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe transaksioni nuk paraqet asnjë pasojë në procesin e rivlerësimit.

39. Votuar kundër për këtë aspekt për dy arsye. Së pari, në parim, koncepti i vlerësimit të pasurive të funksionarëve publikë dhe cilësia e kontrollit të vlerësimit pasuror në rivlerësimin kalimtar, kushtëzohet nga saktësia dhe plotësia e deklarimeve të subjekteve të rivlerësimit. Duke abstraguuar dhe pavarësisht nga pasoja me të cilën një deklarim i cunguar shoqërohet, është parimisht e rëndësishme që subjektet të jenë të ndërgjegjshme për nevojën për transparencë dhe detyrimet që mbajnë barrë në këtë funksion. Së dyti, përlllogaritja e një shume të përfutur nga analiza në Kolegji, që bazohet në një eksperiment teorik, në *anashkalim* të një pretendimi të shprehur dhe përtej një përlllogaritjeje të kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Irma Balli, bazuar në deklaratimet e saj ndër

vite për një shumë *ekzakte të mjeteve monetare* të përdorura prej saj<sup>53</sup> – është i pabazuar dhe bie ndesh me gjuhën dhe frymën e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera pasqyruar në nenet 49, pika 1, germa “b” dhe pika 4, si dhe 52, pika 1, që kërkojnë nga institucionet e rivlerësimit të jenë objektive e të bazohen në prova të besueshme e që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera e të marrin deklarata nga subjektet e rivlerësimit në proces. Së fundmi, ky qëndrim i shumicës bie ndesh edhe me frymën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që përcakton një deklaram të detajuar dhe transparent të pasurive dhe të ardhurave.

40. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer “mosdeklarim të kësaj shume” dhe e ka trajtuar në raport me të ardhurat dhe shpenzimet e vitit të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Nga analiza e kryer në Kolegj, në funksion të ankimit të subjektit të rivlerësimit, rezulton edhe një mungesë burimesh të ligjshme në shumën prej përreth 419.000 lekësh për të krijuar ekuivalentin e shumës së konvertuar. Në këto kushte, në dritën e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit për shkak të ankimit, Kolegji do të duhet të kishte pranuar minimalisht përfundimin e Komisionit, duke theksuar edhe për orientim rëndësinë që ka në procesin e rivlerësimit apo të kontrollit të pasurisë transparenca e veprimeve financiare të kryera nga subjektet e rivlerësimit.

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

---

<sup>53</sup> Subjekti në rezultatet e hetimit administrativ ka pretenduar se ka përdorur kursimet në dispozicion të saj deri më 31.12.2008, në cash, jashtë sistemit bankar, në vlerën 945.108 lekë. Nga përlllogaritja në Kolegj, rezultoi se për të krijuar shumë prej 3.380.000 lekësh që u konvertua në euro, subjektit i nevojiteshin edhe përreth 419.000 lekë.